



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

## **TEMË DIPLOME**

**VLERËSIMI I CILËSISË SË JETËS DHE I KUJDESIT  
PËR PACIENTËT QË I NËNSHTROHEN  
HEMODIALIZËS NË RRETHIN E GJIROKASTRËS SI  
SFIDË E RE PËR PËRMIRËSIMIN E SAJ NGA  
PERSPEKTIVA INFERMIERORE.**

**Master shkencor: Infermieri e Përgjithshme**

**DIPLOMANTI:**

**Mimoza CEKANI**

**UDHËHEQËS SHKENCOR**

**Dr. Rezarta LALO**

**VLORË, TETOR 2020**

## DEKLARATË

Deklaroj se teza e titulluar “*Vleresimi i Cilesise se Jetes dhe Kujdesit per pacientet qe i nenshtrohen Hemodializes ne rrethin e Gjirokastrës si sfide e re per permiresimin e saj nga perspektiva infermierore.*” është puna ime origjinale dhe të gjitha të ardhurat e përdorura për realizimin e kësaj teze janë kontributi im personal.

FIRMA:

DATË: \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020

Mimoza Cekani

## **FALENDERIME**

Dëshiroj të shpreh mirënjohje dhe falenderim për të gjithë personat që më kanë ndihmuar dhe kanë kontribuar në realizimin e këtij punimi, për suportin dhe besimin e tyre.

Në shenjë respekti për mbështetjen dhe ndihmën e vlefshme për mua, falenderoj Udhëheqësen Shkencore **Dr. Rezarta Lalo (Petani)**.

Falenderoj Stafin Drejtues dhe Këshillin e Etikës të Universitetit të Vlorës për mundësinë dhe lejen etike në realizimin e këtij punimi.

Falenderoj Stafin Drejtues dhe Këshillin e Etikës të Spitalit Rajonal të rrethit të Gjirokastrës për mundësinë dhe lejen etike në realizimin e këtij punimi.

Falenderoj stafin infermieror të shërbimit të Dializës për bashkëpunimin në realizimin e studimit për seriozitetin, gadishmërinë e tyre për të më ndihmuar në plotësimin e pyetësorëve.

Një falenderim të veçantë e kam për Znj Alberta Breshanaj, që realizoi përpunimin statistikor të rezultateve të këtij studimi.

Falenderoj të gjithë miqtë e mi për mbështetjen dhe inkurajimin në rrugëtimin e gjatë dhe të rëndësishëm të edukimit tim ne studimet Master i Shkencave.

**FALEMINDERIT TË GJITHËVE!**

## **DEDIKIM**

Këtë punim ia dedikoj familjes time të shtrenjtë që kanë qenë dhe janë frymëzim dhe mbështetje në çdo hap të jetës dhe punës sime, për mbështetjen, mirëkuptimin dhe kohën e privuar për realizimin me sukses të këtij punimi.

**JU FALEMINDERIT PERZEMËRSISHT!**

**PËRMBAJTJA**

1. SHKURTIME.....	vii
2. LISTA E TABELAVE.....	viii
3. LISTA E GRAFIKËVE.....	ix
4. ABSTRAKT .....	10
5. HYRJE.....	11
5.1. IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT DHE RENDESIA E STUDIMIT .....	11
6. PËRMBLEDHJE E LITERATURËS .....	13
6.1. PREVALENCA E SEMNUDJEVE RENALE NE STADIN E FUNDIT NE BOTE DHE NE SHQIPERI .....	13
6.2. TERAPIA E DIALIZES .....	13
6.2.1. SEMUNDJET RENALE KRONIKE .....	13
6.2.2. SHENJAT E SEMUNDJES.....	14
6.2.3. TERAPIA E SEMUNDJES RENALE KRONIKE .....	15
6.2.4. TRAJTIMI I SEMUNDJES SE VESHKAVE NE FAZEN E FUNDIT. LLOJET E TERAPISE.....	16
6.3. FAKTORET RISKANTE .....	17
6.4. PASOJAT NE SHENDET .....	18
6.4.1. CERMA .....	18
6.4.2. ANEMIA .....	19
6.4.3. ACIDOZA METABOLIKE .....	19
6.4.4. SEMUNDJA E KOCKAVE DHE FOSFORI I LARTE (HIPERFOSFATEMIA).....	19
6.4.5. SEMUNDJA E ZEMRES .....	19
6.4.6. KALIUM I LARTE (HIPERKALEMIA).....	19
6.4.7. GRUMBULLIMI I LENGJEVE .....	19
6.5. CILESIA E JETES DHE ROLI I PROFESIONISTEVE TE SHENDETIT NE PERMIRESIMIN E SAJ .....	20
6.5.1. CILESIA E JETES TEK PACIENTET ME SEMUNDJE RENALE KRONIKE. ....	20
6.5.2. ROLI I INFERMIEREVE NE PERMIRESIMI E SHENDETIT TE PACIENTVE ME CKD.....	21
6.5.3. ROLI I INFERMIEREVE NE CILESINE E JETES SE PACIENTEVE ME CKD NGA ANA PSIKOLOGJIKE, FIZIKE DHE PROFESIONALE NE AKSESIN VASKUALR.....	23
6.6. RASTE STUDIMI GLOBALE PER SEMUNDJEN KRONIKE TE VESHKAVE NE FAZEN E FUNDIT .....	30
6.6.1. ITALIA .....	30

6.6.2. GREQIA .....	32
6.6.3. TAJVANI .....	33
6.6.4. JAPONIA.....	35
6.6.5. KINA .....	37
6.6.6. MEKSIKA.....	39
6.6.7. SUDANI .....	40
6.6.8. SENEGALI.....	42
<b>7. PREZANTIMI I STUDIMIT .....</b>	<b>45</b>
7.1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT.....	45
7.2. METODOLOGJIA .....	45
7.2.1. LLOJI I STUDIMIT, VENDI, PERIUDHA, SAMPLI, KRITERET E PERFSHIRJES 45	
7.2.2. INSTRUMENTI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE .....	46
7.2.3. ANALIZA STATISTIKORE E TË DHËNAVE.....	47
7.3. KONSIDERATAT ETIKE .....	47
<b>8. REZULTATET .....</b>	<b>48</b>
8.1. PARAQITJA DESKRIPTIVE E VARIABLAVE.....	48
8.2. PARAQITJA ANALITIKE E VARIABLAVE .....	60
8.2.1. ANALIZA E LIDHJES MIDIS KDCS DHE FAKTOREVE SOCIO- DEMOGRAFIKE DHE KOMORBIDITETIT. ....	60
8.2.2. ANALIZA E LIDHJES MIDIS PCS DHE FAKTOREVE SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE KOMORBIDITETIT .....	62
8.2.3. ANALIZA E LIDHJES MIDIS MCS DHE FAKTOREVE SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE KOMORBIDITETIT .....	64
8.2.4. ANALIZA E LIDHJES MIDIS TREGUESVE TE KDCS ME PCS DHE MCS..	66
8.3. VLERESIMI I TEKNIKES SE KUJDESIT INFERMIEROR PER AKSESIN VASKULAR.....	67
<b>9. DISKUTIMI .....</b>	<b>69</b>
9.1. PËRPARËSITË DHE KUFIZIMET E STUDIMIT .....	72
<b>10. KONKLUZIONE.....</b>	<b>73</b>
<b>11. REKOMANDIME .....</b>	<b>74</b>
<b>12. REFERENCA.....</b>	<b>75</b>

## 1. SHKURTIME

---

- QOL - Quality Of Life, Cilesia e Jetes.
- ESRD - End stage renal disease, stadi terminal i semundjes se veshkave.
- HD - Hemodialize.
- PD - Dialize peritoneale.
- AV - Akses Vaskular
- TZV - Terapi zëvendësuese e veshkave.
- RDT - Renal dialysis therapy, Terapi e dializes renale.
- AKI - Dëmtim akut i veshkave.
- CVC - Kateter venoz qendror.
- AVF - Fistul arteriovenoze.
- CKD - Semundje kronike e veshkave.
- CRD - Semundje renale kronike.
- GFR - Glomerular filtration rate.
- KDQOL - Kidney disease quality of life, Cilesia e jetes se semundjes se veshkave.
- LMIC - Vende me të ardhura më të ulëta.
- NCD - Non-communicable disease, Semundje jo-komunikuese
- PCS - Physical Component Summary, Komponenti fizik i cilesise.
- MCS - Mental Component Summary, Komponenti mendor i cilesise.
- KDCS - Kidney Disease Component Summary, Komponenti i semundjes se Veshkave.
- SF 36 - Short Form 36 Health Survey, Forma e shkurtuar e survejimit te shendetit.
- ANOVA - Analysis of Variance, Analiza e Variancës
- Mes - Mesatare
- Min - Minimum
- Max - Maksimum

## 2. LISTA E TABELAVE

---

Tabela 1: Te dhenat socio-demografike te pacienteve.....	48
Tabela 1.1.....	53
Tabela 1.2.....	53
Tabela 1.3.....	54
Tabela 2: Kategorite e Cilesise se jetes se pacientit dhe piket e vleresimit.....	55
Tabela 2.1.....	56
Tabela 2.2.....	57
Tabela 2.3.....	57
Tabela 2.4.....	57
Tabela 3.1.....	58
Tabela 3.2.....	59
Tabela 3.3.....	59
Tabela 4.1.....	60
Tabela 4.2.....	60
Tabela 5: Lidhja midis Mesatareve te KDCS dhe treguesve socio-demografike & komorbiditeti.....	61
Tabela 5.1: Analize e regresionit .....	61
Tabela 5.2: Analize e regresionit .....	61
Tabela 5.3: Analize e regresionit .....	62
Tabela 5.4: Vleresimi i lidhjes midis KDCS dhe komorbiditetit.....	62
Tabela 6: Lidhja midis Mesatareve te PCS dhe treguesve socio-demografike & komorbiditeti.....	63
Tabela 6.1: Analize e regresionit per lidhjen PCS me Punesimin .....	63
Tabela 6.2: Analize e regresionit per lidhjen PCS me Moshen .....	64
Tabela 6.3: Vleresimi i lidhjes midis PCS dhe komorbiditetit .....	64
Tabela 7: Lidhja midis mesatareve te MCS dhe treguesve socio-demografike dhe komorbiditetit.....	65
Tabela 7.1: Analize e regresionit per lidhjen e MCS dhe Punesimi .....	65
Tabela 7.2: Analize e regresionit per lidhjen MCS dhe Niveli arsimor.....	66
Tabela 8: Analize e regresionit per lidhjen KDCS me komponentin fizik PCS.....	66
Tabela 8.1: Analize e regresionit per lidhjen KDCS me komponentin mendor MCS.....	67
Tabela 9.....	67
Tabela 9.1: Cilesia e kujdesit infermieror per aksesin vaskular .....	68
Tabela 9.2: Vleresimi i lidhjes midis cilesise se kujdesit ndaj aksesit vaskular dhe komponentit fizik te cilesise se jetes.....	68



### 3. LISTA E GRAFIKËVE

---

Grafiku 1/1 .....	49
Grafiku 1/2 .....	50
Grafiku 1/3 .....	50
Grafiku 1/4 .....	51
Grafiku 1/5 .....	51
Grafiku 1/6 .....	52
Grafiku 1/7 .....	52
Grafiku 1/8 .....	54
Grafiku 1/9 .....	55
Grafiku 2.1 .....	56
Grafiku 3.1 .....	58

## 4. ABSTRAKT

---

**Hyrje:** Insuficienca renale kronike eshte nje shqetesim ne rritje i shendetit publik ne te gjithë boten perfshire edhe vendin tone per arsye te semundshmerise dhe vdekshmerise se larte. Për shkak se kërkon trajtim gjatë gjithë jetës sic eshte hemodializa, cilësia e jetës (QOL) se pacientëve mund të dëmtohet ndjeshëm. Trajtimi kronik i hemodializës kërkon akses vaskular te cilat kane nevojë per kujdes te vecante. Prandaj studimi i faktoreve qe prekin cilesine e jetes dhe kujdesin gjate implementimit te terapise jane te domosdoshme per tu vleresuar me qellim permiresimin e tyre nga perspektiva infermiore.

**Metodologjia:** Eshte nje studim cross-seksional i realizuar ne Njesine e Hemodializes te Spitalit Rajonal te rrethit te Gjirokastrës gjate periudhes korrik-gusht 2020. Per mbledhjen e te dhenave do të përdoret pyetesori Cilësia e Jetës në Sëmundjet e Veshkave - një formë e shkurtër e (KDQOL-SF) si edhe një listë kontrolli në lidhje me teknikat e kujdesit infermior për aksesin vaskular. Te dhenat jane perpunuar me programin statistikor SPSS-23. Sinjifikanca u testua nga testi t i pavarur, analiza e variancës F, dhe analiza e regresionit të shumëfishtë linear. Niveli i pranuar i sinjifikances eshte  $p < 0.05$ .

**Rezultatet:** Niveli i cilesise se jetes te pacienteve qe i nenshtrohen HD ne rrethin e Gjirokastrës eshte mesatar. Nivel më i ulet i cilesise ishte komponenti fizik me rezultat mesatar  $41.8 \pm 17.6$ . Pacientet me nivel ekonomik ( $50.8 \pm 5.4$  pike) dhe arsimor ( $55.1 \pm 8.6$ ) me te larte kishin nje cilesi jete me te mire lidhur me statusin e semundjes se veshkave (KDCS), kurse pacientet me moshe më shume se 50 vjec ishin më te prirur per te patur nje shendet fizik më te dobet ( $44.4 \pm 3.5$ ). Te qenurit i punesuar u gjet se ka nje ndikim pozitiv ne aspektin psikologjik ( $52.45 \pm 3.02$ ), por rezultate te uleta te cilesise ne lidhje me komponentin fizik ( $42.8 \pm 3.2$ ). Pacientet qe vuajne nga diabeti kane rezultate më te uleta te komponentit fizik PCS dhe KDCS. Cilesia e kujdesit per aksesin vaskular ishte gjithshu e nivelit mesatar me problemin kryesor ne proceduren e futjes se ages ne aneurizem (48%) apo mos respektimit te distances se ages nga fistula (50%).

**Perfundime:** Punonjesit e kujdesit shendetesor duhet te jene te vetdijshem per cilesine e ulet te jetes sidomos tek grupmoshat mbi 50 vjec, ata me nivel te ulet socio-ekonomik dhe arsimor dhe me semundje bashkeshoqeruese, te cilat duhet te konsiderohen grupet target per te adaptuar nevojat individuale dhe te jene ne fokus te edukimit parandalues dhe kujdesit te tyre. Administratorët e kujdesit vaskular duhet të forcojnë performancën e tyre mbikëqyrëse per parandalimin e gabimeve gjate teknikes se aksesit vaskular.

## 5. HYRJE

---

### 5.1. IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT DHE RENDESIA E STUDIMIT

Sëmundja renale në stadin e fundit (ESRD) është përfshirë së fundi në grupin e sëmundjeve jetësore të shekullit të 21-të. Sëmundja renale në fazën përfundimtare (ESRD) është një sëmundje e tillë kronike që shkakton një aftësi të kufizuar të lartë në fusha të ndryshme të jetës së pacientëve, duke çuar në dëmtim të cilesive të jetës së tyre (QOL)<sup>1,2</sup>. Kjo do të thotë se disa pacientë me këtë sindrom të parikthyeshëm, pas disa vitesh nga fillimi, kërkojnë terapi zëvendësuese të veshkave (TZV). Dializa është trajtimi kryesor i kesaj sëmundjeje<sup>3</sup>. Trajtimi kronik i hemodializës kërkon akses vaskular. Ky akses mund të sigurohet nga një kateter venoz qendror (CVC), një fistul arteriovenoze (AVF) ose një graft arteroventoz i futur midis një arterie dhe një ene venoze të gjakut<sup>4</sup>. CVC përdoret zakonisht për pacientët që kanë nevojë për dializë afatshkurtër ose për pacientët enet venoze sipërfaqësore të cilëve janë hipoplastike ose të veshura për shkak të procedurave të mëparshme kirurgjikale<sup>5</sup>. Graftet arteriovenoze mund gjithashtu të përdoren si një metodë afatgjatë për aksesin vaskular<sup>6,7</sup>.

Sidoqoftë, një AVF konsiderohet metoda më e favorshme në hemodializën kronike për sa i përket funksionit, kohëzgjatjes dhe shkallës më të ulët të komplikacioneve, ndërsa CVC dhe graftet arteriovenoze shoqërohen me incidence më të shpeshtë të infeksionit, okluzion, tromboza si dhe stenoza të venave. Prandaj, vendet e aksesit vaskular kanë nevojë për kujdes të veçantë për të rritur mirëmbajtjen e tyre<sup>8,9</sup>. Komplikacionet e hyrjes vaskulare janë shkak kryesor i shtrimit në spital dhe sëmundshmërisë tek pacientët me sëmundje kronike të veshkave dhe përbëjnë 16% deri në 25% të shtrimeve në spital në mesin e pacientëve që kalojnë hemodializën në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë<sup>10</sup>.

Kushtet e trajtimit dhe përparimi i sëmundjes kronike kufizojnë individin me sëmundje kronike të veshkave (CKD) dhe, për rrjedhojë, ato janë faktorë agresivë që shkaktojnë stres, izolim social si dhe kufizime në mundësinë e levizjeve dhe turneve, ulje të aktivitetit fizik, varësisë dhe ndjenjës së frikës dhe pasigurisë në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien. Prandaj, cilësia e jetës është një faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm sepse ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e trajtimeve dhe ndërhyrjeve në shëndet<sup>11</sup>.

Megjithë përparimet teknologjike dhe terapeutike të arritura deri më sot, për të përmirësuar gjendjen klinike dhe për të rritur mbijetesën e pacienteve me CKD, niveli i tyre i cilësisë së jetës vazhdon të dobësohet<sup>12</sup>. Duke ditur që kujdesi infermieror vazhdimisht ka nevojë për ndryshime për të përmbushur nevojat e individit, është e nevojshme dhe jashtëzakonisht e rëndësishme, të avancohet në fushën e kërkimit si një sfidë për të përmirësuar cilësinë e kujdesit me impakt pozitiv në cilësinë e tyre të jetës<sup>12,13</sup>.

Sipas të dhënave nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Shqipëri në muajin dhjetor 2018, numri total i pacientëve që janë trajtuar me dializë në institucionet shëndetësore publike dhe private, është 1250, përkatësisht në QSUT dhe spitalin rajonal Gjirokastër, në spitalet jopublike

dhe nëpërmjet partneritetit publik-privat të hemodializës, në spitalet rajonale të Lezhës, Elbasanit, Vlorës, Korçës dhe Shkodrës. Aktualisht në Spitalin e Gjirokastrës janë rreth 50 pacientë që vijnë edhe nga qytete të tjera të jugut të Shqipërisë të cilët i nënshtrohen hemodializës<sup>14</sup>. Bazuar në hulumtimet e fundit, në Shqipëri ka pak informacion shkencor në lidhje me faktoret që ndikojnë në cilësinë e jetes së pacienteve që i nënshtrohen dializës<sup>15-17</sup>. Gjithashtu, në ditët e sotme nuk ka studime në Shqipëri që vlerësojnë rolin e cilësisë së kujdesit në qëndrueshmërinë dhe performancën e vendit të hyrjes vaskulare dhe rreziqet që vijnë nga injorimi i tij.

Për këtë arsye kam vendosur të ndermarr një studim që vlerëson cilësinë e jetes dhe kujdesin për pacientet me CKD që i nënshtrohen trajtimit me hemodializë në Spitalin Rajonal të Gjirokastrës në mënyrë që të përcaktojmë faktoret që prekin më së shumti mirëqenien e shëndetit të tyre me qëllim implementimin e nderhyrjeve për përmirësimin e cilësisë së kujdesit nga perspektiva infermiere.

## **6. PËRMBLEDHJE E LITERATURËS**

---

### **6.1. PREVALENCA E SEMNUDJEVE RENALE NE STADIN E FUNDIT NE BOTE DHE NE SHQIPERI**

Studimet tregojnë se mbi 850 milionë njerëz në mbarë botën kanë një formë të sëmundjes së veshkave. Sëmundja kronike e veshkave (CKD) aktualisht po prek 18.4% të popullatës evropiane. Sëmundjet kronike të veshkave (CKD), të përcaktuara si anomalitë e strukturës ose funksionit të veshkave të vazhdueshme për më shumë se 3 muaj, janë forma më e zakonshme e sëmundjeve të veshkave. Një përmbledhje sistematike e CKD në popullatat e përgjithshme në të gjithë botën në vitin 2018 gjetën një prevalencë të vazhdueshme globale të CKD prej 11-13%. Përsa i përket gjinise rezultatet treguan se 44.6% e te prekurve me CKD ishin meshkuj dhe pjesa tjetër 55.4% femra. Nga 5.3 deri në 10.5 milion njerëz kërkojnë dializë ose transplantim në bote. Studimet e bëra në Qëndrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës tregojnë se CKD janë më të shpeshta në personat 65 vjeç e sipër me rreth 38%, për personat e moshave 45-64 vjeç janë 13% dhe 7% për personat e moshave 18-44 vjeç.<sup>125,130</sup>

Në Shqipëri 14% e popullatës është e prekur nga sëmundjet kronike të veshkave në 4 vitet e fundit, afërsisht 1 në 10 persona kanë CKD në një stad të caktuar. Rreth 1250 pacientë në gjithë Shqipërinë të cilët marrin dializë. Sëmundjet kronike të veshkave mund të ndodhin në çdo moshë, por ato janë më të zakonshme me kalimin e viteve dhe kryesisht te femrat të cilat preken 2 % me shumë se meshkujt. Megjithatë gjysma e individëve 75 vjeç e lart kanë CKD në një stad të caktuar, shumë nga ata nuk kanë një sëmundje të veshkave, por një plakje normale të veshkave. Këto sëmundje prekin çdo njeri pavarësisht nga moshën.<sup>14</sup>

### **6.2. TERAPIA E DIALIZES**

#### **6.2.1. SEMUNDJET RENALE KRONIKE**

Sëmundjet kronike të veshkave po bëhen çdo ditë e më shumë një problem i shëndetit publik në mbarë botën dhe shoqërohen me prekshmëri dhe vdekshmëri të lartë. Gjithashtu ato janë problem social dhe ekonomik për të sëmurët, familjet e tyre dhe gjithë shoqërinë. Veshkat preken nga një shumëllojshmëri sëmundjesh dhe çrregullimesh të saj. Në shumicën e sëmundjeve të veshkave, sulmohen njësitë e filtrimit të veshkave (nefronet) dhe dëmtojnë aftësinë e tyre për të eliminuar mbeturinat dhe lëngjet e tepërta. Nuk ka asnjë shkak të vetëm të sëmundjes kronike të veshkave. Disa forma të sëmundjes mund të jenë të trashëguara, ndërsa të tjerat janë të fituara.<sup>126</sup>

Sëmundjet kronike të veshkave janë një dëmtim ose humbje progresive të funksionit të veshkave. Ky dëmtim zhvillohet në mënyrë të ngadaltë dhe të fshehtë gjatë një periudhe kohore që zgjat nga disa

muaj deri disa vite, çka bën që shpesh të sëmurët diagnostikohen në një stad të përparuar të sëmundjes.

Nëse nefronet janë të dëmtuar, ato ndalojnë së punuari. Nefronet e shëndosha mund të kryejnë një punë shtesë për një farë kohe, por nëse dëmtimi vazhdon, ato dalin nga funksioni dhe nefronet e mbetura nuk mund të filtrojnë mjaftueshëm gjakun për të qenë të shëndetshëm.

Dëmtimi kronik i veshkave vjen si pasojë e faktorëve patologjik, psikologjik dhe social ekonomik të cilat paraqesin një ndër problemet e shëndetit publik. Ndërsa në një numër të konsiderueshëm të rasteve nuk është e mundur të përcaktohet se kush është shkaku i saktë i kësaj sëmundjeje, e cila nëse nuk trajtohet që në stadet më të hershme mbart pasoja të rënda. Një person mund të ketë dëmtim të veshkave shume vite përpara së të jetë i nevojshëm fillimi i trajtimit me dializë apo transplant. Në shumë të sëmurë, edhe pse veshkat janë të dëmtuara edhe në stade shumë të përparuara të sëmundjes, apo edhe në dializë mund të vazhdojnë të prodhojnë urinë. Për këtë arsye, këto substanca, do të vazhdojnë të qarkullojnë dhe të grumbullohen në organizëm. Prandaj nuk mund të vlerësohet funksioni i veshkës vetëm nëpërmjet sasisë së urinës së prodhuar. Faktorë të tjerë më pak të zakonshme të veshkave përfshijnë: inflamacionin, infeksionin, trashëgiminë familjare, bllokimin e gjatë të sistemit urinar, përdorimin për një kohë të gjatë të disa ilaçeve që mund të shkaktojnë këto sëmundje, jeta sedentare etj.<sup>127</sup>

### **6.2.2. SHENJAT E SEMUNDJES**

Shenjat e hershme të sëmundjes janë të fshehta dhe shpesh nuk e kuptoni që keni të pranishme shenjat e sëmundjes. Shenja të tilla mund të jenë: dobësi; mungesë përqendrimi; mungesë oreksi; pagjumësi; ngërçe gjatë natës; ënjtje të këmbëve dhe përreth syve sidomos në mëngjes; tharje të lëkurës dhe kruarje; urinim i shpeshtë dhe sidomos gjatë natës; etje për ujë.<sup>128</sup>

Diagnostikimi dhe ndjekja e të sëmurëve me CRD. Diagnostikimi dhe vlerësimi i funksionit të veshkës do të ndihmojë për ndjekjen dhe fillimin e mjekimit me qëllim ngadalësimin e dëmtimit të funksionit të saj.

Ekzaminimet e nevojshme janë: Matja e presionit arterial; Analiza e urinës; Proteinat janë substanca që normalisht nuk eliminohen me urinë. Në rastet kur veshkat tuaja janë të dëmtuara atëherë proteinat apo albuminat kalojnë në urinë. Prania persistente e albuminës në urinë mund të jetë një shenjë e hershme e dëmtimit të veshkave; Analizë gjaku për matjen e nivelit të kreatinemisë; Matja e filtracionit glomerular apo GFR që tregon nivelin e funksionit të veshkës; Ekografi e aparatit urinar. Ky ekzaminim jep të dhëna mbi madhësinë dhe formën e veshkës, praninë ose jo të bllokimit të rrugëve urinare, të gurëve në veshkë apo tumoreve të aparatit urinar; Analizë e gjakut komplet.<sup>131</sup>

Përcaktimi i stadit të CRD bëhet duke përcaktuar GFR. Filtracioni glomerular apo GFR përdoret për të treguar se cili është niveli i dëmtimit të funksionit të veshkave. Sa më shumë avancon sëmundja aq më shumë ulët GFR. GFR mbi 60 tregon një funksion normal të veshkave GFR nën 60 tregon praninë e sëmundjes renale GFR nën 15 ose dhe më e ulët tregon praninë e insuficiencës renale dhe fillimi i terapisë renale zëvendësuese me dializë apo transplant është i domosdoshëm.<sup>129</sup>

### 6.2.3. TERAPIA E SEMUNDJES RENALE KRONIKE

Trajtimi i sëmundjes do të varet nga stadi i saj dhe nga prania ose jo e sëmundjeve të tjera shoqëruese. Trajtimi zakonisht përbëhet nga masa për të ndihmuar në kontrollin e shenjave dhe simptomave, zvogëlimin e komplikimeve dhe përparimin e ngadaltë të sëmundjes. Nëse veshkat dëmtohen rëndë, mund të kenë nevojë për trajtim për sëmundjen e veshkave në fazën përfundimtare Ndjekja dhe trajtimi që në stadet e para mund të parandalojë ose të ngadalësojë progresionin e CKD në stadin e insuficiencës së veshkës, stad në të cilin fillimi i dializës është i nevojshëm.<sup>132</sup>

Qëllimi kryesor i trajtimit të sëmundjes në stadet e hershme është: Parandalimi ose ngadalësimi i progresionit të CKD; Ulja e rrezikut për sëmundje kardio-vaskulare.

- Sëmundja Renale Kronike stadi 1-2. Në këtë stad të sëmundjes mundet që pacienti të mos ketë shenja specifike. Në analizën e gjakut mund të vërehet një rritje e lehtë e nivelit të kreatinemisë. Në analizën e urinës mund të vërehet prania e albuminës apo e rruazave të kuqe që mund të sugjerojë për praninë e një sëmundje në veshka. Trajtimi në këtë stad të sëmundjes mund të konsistojë në pakësimin e proteinave në dietë, dhe në disa raste në përdorimin e medikamenteve që ulin presionin e gjakut. Anemia shfaqet rrallë në këtë stad të sëmundjes.
- Sëmundja Renale Kronike stadi 3-4. Në këtë stad mundet që pacienti të ndjehet mirë ose të ketë ndonjë nga shqetësimet e mëposhtme: Rritje të nivelit të kreatinemisë; Lodhje; Ënjtje në duar, këmbë, apo përreth syve; Pakësim të oreksit; Ngadalësim të tretjes së ushqimit; Ndryshim në sasinë, ngjyrën dhe shpeshhtësinë e urinimit; Vlera të larta të presionit të gjakut. Në këtë stad është shumë e rëndësishme të respektohet dieta e rekomanduar (pakësim i proteinave, përdorimi i ushqimeve që përmbajnë pak kalium, fosfor, dhe kripë). Disa lloje të sëmundjes së veshkave mund të trajtohen në varësi të shkakut themelor. Shpesh, sëmundja kronike e veshkave nuk ka shërim.
- Sëmundja Renale Kronike stadi 5. Funkcioni i veshkës në këtë stad të sëmundjes është afërsisht 10-15%. Shenjat klinike që mund të keni në këtë stad: Anemi; Dhimbje koke; Lodhje; Të përziera, të vjella, pakësim të oreksit; Etje për ujë; Ngërçe të muskujve; Urinim të shpeshtë gjatë natës; Kruarje; Vlera të larta të presionit arterial; Edema; Ndryshime të ciklit menstrual; Pakësim të sasisë së urinimit. Në këtë stad të sëmundjes është e nevojshme fillimi terapisë renale zëvendësuese, hemodializë, dializë peritoneale apo transplant të veshkës. Kjo procedurë nuk është e nevojshme të kryhet muaj përpara se të fillojë trajtimi si në rastin e hemodializës.<sup>133</sup>

Trajtimi i komplikimeve:

Komplikimet e sëmundjes së veshkave mund të kontrollohen për t'ju bërë më të rehatshme. Trajtimet mund të përfshijnë:

- Medikamente të tensionit të lartë. Njerëzit me sëmundje të veshkave mund të pësojnë përkeqësim të presionit të lartë të gjakut. Mjeku mund të rekomandojë medikamente për të ulur presionin e gjakut - frenuesit zakonisht të enzimës konvertuese të angiotenzinës ose

bllokuesit e receptorëve të angiotensin - dhe për të ruajtur funksionin e veshkave. Ilaçet për presionin e lartë të gjakut fillimisht mund të ulin funksionimin e veshkave dhe të ndryshojnë nivelin e elektrolitit, kështu që mund t'ju duhet teste të shpeshta të gjakut për të monitoruar gjendjen tuaj. Mjeku ka të ngjarë të rekomandojë gjithashtu një pilulë uji (diuretik) dhe një dietë me kripë të ulët.

- Medikamentet për të ulur nivelin e kolesterolit. Mjeku mund të rekomandojë ilaçe të quajtura statina për të ulur kolesterolin . Njerëzit me sëmundje kronike të veshkave shpesh pësojnë nivele të larta të kolesterolit të keq, i cili mund të rrisë rrezikun e sëmundjeve të zemrës.
- Medikamentet për të trajtuar aneminë. Në situata të caktuara, rekomandohet shtesa të hormonit eritropoietin, ndonjëherë me hekur të shtuar. Eritropoietina plotëson ndihmën në prodhimin e më shumë qelizave të kuqe të gjakut, të cilat mund të lehtësojnë lodhjen dhe dobësinë që lidhen me aneminë.
- Medikamentet për lehtësimin e ënjtjes. Njerëzit me sëmundje kronike të veshkave mund të mbajnë lëngje. Kjo mund të çojë në ënjtje në këmbë, si dhe presion të lartë të gjakut. Ilaçet e quajtura diuretikë mund të ndihmojnë në ruajtjen e ekuilibrit të lëngjeve në trupin tuaj.
- Medikamentet për të mbrojtur kockat. Përdorimi shtesë të kalciumit dhe vitaminës D për të parandaluar kockat e dobëta dhe për të ulur rrezikun e frakturës. Gjithashtu mund të merrni ilaçe të njohura si një fosfat lidhës për të ulur sasinë e fosfatit në gjak dhe për të mbrojtur enët e gjakut nga dëmtimet nga depozitat e kalciumit (kalcifikimi).
- Një dietë më e ulët e proteinave për të minimizuar produktet e mbeturinave në gjak. Ndërsa trupi përpunon proteina nga ushqimet, ajo krijon produkte të mbeturinave që veshkat duhet të filtrojnë nga gjaku. Për të zvogëluar sasinë e punës që duhet të bëjnë veshkat mund të rekomandohet të konsumohen më pak proteina, gjithashtu një dietolog i cili mund të sugjerojë mënyra për të ulur marrjen e proteinave.<sup>134</sup>

#### **6.2.4. TRAJTIMI I SEMUNDJES SE VESHKAVE NE FAZEN E FUNDIT. LLOJET E TERAPISE**

Trajtimi për sëmundjen e veshkave në fazën e fundit përfshijnë dializën ose transplantin e veshkave. Ne disa raste, ndryshimi i stilit të jetës dhe medikamentet mund të ndihmojnë. Nëse veshkat nuk mund të bëjnë vete pastrimin e mbeturinave dhe lëngjeve zhvillohet një dështim i plotë të veshkave, pra sëmundje të veshkave në fazën e fundit. Në atë pikë, nevojitet për dializë peritoneale, hemodializë ose transplantim të veshkave.

- Dializë peritoneale

Dializa peritoneale kryen heqjen artificiale të toksinave dhe likidet shtesë duke përdorur murin abdominale të quajtur membrana peritoneale, si një filtër membrane nëpër të cilin likidet dhe substancat e tretura (elektrolite, glukozë, albumin, ure e.t.j.) shkëmbehen nga gjaku, kur veshkat nuk mund ta bëjnë më këtë. Dializa peritoneale preferohet sepse përdoret një teknikë më e thjeshtë dhe siguron ndryshime më graduale fiziologjike sesa hemodializa. Lloji më i zakonshëm është dializë peritoneale ambulatorie e vazhdueshme, e cila lejon pacientin të menaxhojë procedure në shtëpi me



qese dhe rjedhjen me anë të gravitetit. Në dializën peritoneale, rjedhja kryhet me anë të një tubi të hollë (kateter) i futur në bark e cila mbush zgavrën e barkut me një zgjidhje dialize që thith mbeturinat dhe lëngjet e tepërta. Pas një periudhe kohe, zgjidhja e dializës kullon nga trupi, duke mbajtur toksinat më vete. Kjo kërkon një kohë më të gjatë të pushimit gjatë natës dhe një total prej 3-5 cikle në ditë, 7 ditë në javë. Për këtë nuk kërkohet ndonjë aparat i veçantë përveç se nevojitet një aparat i automatizuar për të mbushur dhe zbrazur likidin e dializës në intrvale të përcaktuara. Dializa peritoneale është e ngjajshme në parim me hemodializën.

- Hemodializa

Trajtimi i hemodializës konsiston në qarkullimin e gjakut të pacientit jashtë trupit nëpërmjet një qarku (I quajtur “qarku i dializës”) Ajo ndan tretësirat me anë të difuzioneve të ndryshëm me anë të një membrane të vendosur midis gjakut solucionit të dializës. Gjaku kalohet në një veshkë artificiale (dializues) për heqjen e likidit të tepërt dhe toksinave dhe më pas të kthehet në qarkullim venoz. Pra gjaku duhet të kalojë në një makineri dialize. Hemodializa kërkon një rrugë aksesit në gjak me anë të një kateteri arterio venoz ose grafit sintetik. Kjo metodë është e shpejtë dhe efikase për të hequr urenë dhe produktet e tjera toksike. Hemodializa kryhet në ambiente spitalore, ose në qendra ambulatoriale dialize 3 herë në javë për 4 orë.

- Transplantimi i veshkave

Një transplant i veshkave përfshin vendosjen kirurgjikale të një veshkë të shëndetshme nga një donator në trupin e njeriut. Veshkat e transplantuara mund të vijnë nga dhurues të vdekur ose të gjallë. Do të duhet të merren ilaçe për pjesën tjetër të jetës për ta mbajtur trupin të mos refuzojë organin e ri. Kur bëhet transplant i veshkave nuk ka nevojë për të bërë dializë. Për disa që zgjedhin të mos kenë dializë ose transplantim të veshkave, një mundësi e tretë është trajtimi i dështimit të veshkave me masa konservative. Sidoqoftë, pasi kanë dështim të plotë të veshkave, jetëgjatësia në përgjithësi do të ishte vetëm disa muaj.<sup>39</sup>

### 6.3. FAKTORET RISKANTE

Dy faktorët patologjikë më kryesor të sëmundjes kronike të veshkave janë diabeti dhe presioni i lartë i gjakut, të cilat janë përgjegjëse deri në dy të tretat e rasteve familje që vuajnë me sëmundje të veshkave. Këta individë janë më të predispozuar se të tjerë për të zhvilluar sëmundje të veshkave.

- Presioni i lartë i gjakut (hipertensioni) shkakton një të katërtën e të gjitha rasteve. Presioni është matja e forcës që ushtrohet kundrejt murit të arterieve nga pompimi i gjakut prej zemrës. Presioni i lartë i gjakut, ose hipertensioni, ndodh kur rritet presioni i gjakut kundër mureve të enëve të gjakut. Në rastet kur presioni i gjakut nuk mbahet në vlerat e rekomanduara nga mjeku atëherë ai mund të jetë një shkak kryesor i sulmeve në zemër, shkaktar i infarktit të miokardit, iskemisë së trurit, goditje dhe sëmundje kronike të veshkave. Gjithashtu, sëmundja kronike e veshkave mund të shkaktojë presion të lartë të gjakut.<sup>135,136</sup>

- Diabeti shkakton një të tretën e të gjitha rasteve dhe që është shkaku më i zakonshëm i insuficiencës renale. Diabeti ndodh kur sheqeri në gjak është shumë i lartë, duke shkaktuar dëme në shumë organe në trupin e njeriut, përfshirë veshkat dhe zemrën, si dhe enët e gjakut, nervat dhe sytë.<sup>137</sup>

Analizat e thjeshta të gjakut e urinës mund të zbulojnë praninë e CKD-ve, dhe një trajtim me kosto të lirë mund të ngadalësojë progresin e sëmundjeve, të reduktojë rrezikun e atakut të panikut dhe atakut kardiak të lidhura me të, si dhe të përmirësojë cilësinë e jetës.

- Glomerulonefriti është një grup sëmundjesh që shkaktojnë inflamacion dhe dëmtim të njësive filtruese të veshkave. Këto çrregullime janë lloji i tretë më i zakonshëm i sëmundjeve të veshkave.
  - a) Sëmundjet e trashëguara, siç është sëmundja polikistike e veshkave, e cila bën që kistet e mëdha të formohen në veshka dhe dëmtojnë indet përreth.
  - b) Malformimet që ndodhin ndërsa fëmija zhvillohet në barkun e nënës së saj. Për shembull, mund të ndodhë një ngushtim që parandalon rrjedhjen normale të urinës dhe bën që urina të rrjedhë përsëri në veshkë. Kjo shkakton infeksione dhe mund të dëmtojë veshkat.
  - c) Lupus dhe sëmundje të tjera që ndikojnë në sistemin imunitar të trupit.
  - d) Pengesat e shkaktuara nga probleme si gurët në veshka dhe bllokimi prej tyre i rrugëve urinare, tumoret ose një gjëndër e prostatës në zona e rritur.
  - e) Infeksione të përsëritura urinare.<sup>40,138,139</sup>

## 6.4. PASOJAT NE SHENDET

Veshkat ndihmojnë tërë trupin të funksionojë siç duhet, gjithashtu CKD mund të shkaktojë probleme me mënyrën e funksionimit të pjesës tjetër të trupit. Disa nga ndërlikimet e zakonshme të CDK përfshijnë aneminë, sëmundjen e eshtrave, sëmundjet e zemrës, kaliumin e lartë, kalciumin e lartë dhe ndërtimin e lëngjeve.

- Cerma
- Anemi
- Acidoza metabolike
- Sëmundja e kockave dhe fosfori i lartë (hipfosfatemia)
- Sëmundja e zemrës
- Kalium i lartë (hiperkalemia)
- Grumbullimi i lëngjeve

### 6.4.1. CERMA

Më së shpeshti, sëmundja e veshkave mund të shkaktojë cermë. Sidoqoftë, Cerma mund të çojë gjithashtu në sëmundje të veshkave. Meqenëse acidi urik filtrohet përmes veshkave, të dy sëmundjet lidhen.<sup>140</sup>

#### **6.4.2. ANEMIA**

Veshkat ndihmojnë trupin të bëjë qelizat e kuqe të gjakut. Kur veshkat nuk po punojnë siç duhet, trupi mund të mos ketë mjaft qeliza të kuqe të gjakut. Kjo gjendje quhet anemi.<sup>141</sup>

#### **6.4.3. ACIDOZA METABOLIKE**

Acidoza metabolike është një përbërje acidi në trupin. Veshkat ndihmojnë në mbajtjen e ekuilibrit të duhur të acideve në trup. Acidoza metabolike është e zakonshme në njerëzit me sëmundje të veshkave sepse veshkat e tyre nuk po e filtrojnë mjaft mirë gjakun e tyre.<sup>142</sup>

#### **6.4.4. SEMUNDJA E KOCKAVE DHE FOSFORI I LARTE (HIPERFOSFATEMIA)**

Për të pasur kocka të shëndetshme nevojitet sasia e duhur për kalcium dhe vitaminë D. Veshkat e shëndetshme ndihmojnë në mbajtjen e kockave të shëndetshme, pra veshkat e dëmtuara mund të mos jenë në gjendje ta bëjnë këtë punë të rëndësishme.<sup>143</sup>

#### **6.4.5. SEMUNDJA E ZEMRES**

Sëmundja e zemrës mund të shkaktojë sëmundje të veshkave, por sëmundja e veshkave gjithashtu mund të shkaktojë sëmundje të zemrës. Sëmundja e zemrës është shkaku më i zakonshëm i vdekjes tek njerëzit në dializë.

Kur veshkat nuk po funksionojnë mirë, ata nuk mund të mbështesin pjesët e tjera të trupit ashtu si duhet. Kjo mund të shkaktojë probleme me zemër.<sup>144</sup>

#### **6.4.6. KALIUM I LARTE (HIPERKALEMIA)**

Veshkat e shëndetshme filtrojnë kalium shtesë (një mineral që gjendet në shumë ushqime) nga gjaku. Në CKD, duhet të kufizohet kaliumi sepse veshkat mund të mos jenë në gjendje ta filtrojnë atë.<sup>145</sup>

#### **6.4.7. GRUMBULLIMI I LENGJEVE**

Veshkat e shëndetshme nxjerrin lëng shtesë (të lëngshëm) nga gjaku. Kur veshkat nuk po funksionojnë siç duhet, nuk mund të nxjerrin lëng të mjaftueshëm. Kjo mund të bëjë që lëngu shtesë në gjakun të ndërtohet në trup. Të kesh shumë lëng në trupin mund të shkaktojë probleme me zemrën dhe mushkëritë. Mund të shkaktojë gjithashtu tension të lartë, që është shkaku i dytë më i zakonshëm i dështimit të veshkave. Kontrolli i marrjes së lëngjeve mund të ndihmojë në parandalimin e këtyre problemeve dhe të zvogëlohet rreziku për dëmtimin e mëtejshëm të veshkave. Nëse trupi mban shumë lëng, mund të vërehet një rrahje të zemrës dhe ënjtje që fillon në këmbët dhe kyçet e këmbës dhe lëviz lart. Kufizimi i sasisë së lëngut mund të ndihmojë për një shëndet më të mirë.<sup>41</sup>

Disa pasoja të tjera shëndetësore të CKD përfshijnë:

- Rritja e shfaqjes së infeksioneve
- Humbja e oreksit ose të ngrënit më pak
- Depresioni ose cilësia e ulët e jetës

## **6.5. CILESIA E JETES DHE ROLI I PROFESIONISTEVE TE SHENDETIT NE PERMIRESIMIN E SAJ**

Në Shqipëri kohët e fundit ka një rritje të pacientëve që hyjnë në dializë dhe moshën e tyre mesatare varjon në 50 vjeç, madje ka një tendencë në rritje të pacientëve për dializë edhe në grupmosha më të reja. Aktualisht në klinikën e dializës në Spitalin Shtetëror "Omer Nishani" në Gjirokastrë i cili është hapur në vitin 2010, ku bëjnë Dializë rreth 50 pacientë me një mesatare moshe rreth 50 vjeç. Pas vitit të parë të dializës 10% të tyre i ruajtën aftësitë e tyre të përkujdesit vetjak ditor, por gjatë vitit të 2-të të trajtimit me dializë këta pacientë patën një rënie të theksuar të aftësive fizike. Kjo erdhi sepse vetë shtimi i seancave të dializës nga 2 herë në javë në 3 herë në javë u shoqërua edhe me një monotoni të mërzitshme. Këta paciente janë shumë të ndryshëm edhe nga ndryshime klimaterike, të cilat lidhen ngushtë edhe me ndryshime të shpeshta të hipertensionit arterial dhe me shumë patologji të tjera.

### **6.5.1. CILESIA E JETES TEK PACIENTET ME SEMUNDJE RENALE KRONIKE**

Sëmundja kronike e veshkave (CDK) ka një ndikim të madh në cilësinë e jetës. Simptomat shfaqen dhe shkaktojnë ndryshime thelbësore në stilin e jetës nga fazat e hershme të sëmundjes tek trajtimi i zëvendësimit siç janë hemodializa (HD), dializa peritoneale (PD) ose transplantimi i veshkave. CDK shoqërohet pa dyshim me uljen e cilësisë së jetës, dhe ekziston një lidhje midis madhësisë së efektit në cilësinë e jetës dhe shkallës së filtrimit glomerular. Cilësia më e prekur e zonave të jetës është puna dhe koha e lirë, jeta familjare, gjumi dhe pushimi. Megjithatë një trajtim adekuat i pacientëve gjatë fazës së predializës mund të ngadalësojë përparimin e CDK dhe që njihet si një faktor i rëndësishëm i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë pra, i cilësisë së jetës të pacientëve. Fillimi i trajtimit të dializës është pika e kthimit të pacientëve në konceptin e tyre për cilësinë e jetës. Ata kalojnë nga një situatë e "jetës normale" (shpesh e idealizuar) në një gjendje "rreziku të vdekshëm" ose "jeta pa shëndet" që kërkon dializën të mbetet gjallë. Ka disa aspekte që pacientët e prekur do të ndjehen të ndryshuar.<sup>146</sup>

- Mirëqenia

Përsëritja dhe shpeshtësia e procedurës së dializës vazhdimisht kujton një nga sëmundjet, duke favorizuar vetë-analizën që ekzagjeron fenomenet fiziologjike. Nga ana tjetër, dëshira dhe aktiviteti i ulur seksual (i pranishëm në deri në 50% të pacientëve) përjetohej si një shenjë e moshës së përparuar dhe ndërhyr në marrëdhënie. Më në fund, kufizimet dietike perceptohen (dhe për këtë arsye shpesh injorohen) si privim i "kënaqësisë" së fundit që pacientët mbajnë.

- Imazhi i trupit

Ngjyra e lëkurës, erë e trupit, humbja e funksionit urinar, pafuqia seksuale, fistula e brendshme artero-venoze ose prania e kateterit peritoneal, plagët ose distensioni i barkut ndihmojnë pacientët të perceptojnë trupin e tyre negativisht dhe me ndjenjë inferioriteti. Dhe këto ndjenja do të kufizojnë marrëdhëniet shoqërore dhe familjare, duke inkurajuar izolimin.

- Autonomia

Frekuenca e dializës (qoftë HD ose seanca shkëmbimi në PD) ndërhyr dhe kufizon stilin e jetës së pacientëve. Nga ana tjetër, ndjenjat e inferioritetit lehtësojnë përkeqësimin fizik, pasivitetin, neglizhencën dhe varësinë, shpesh të përmirësuar nga ndihma me qëllim të mirë nga familja e pacientit.

- Qëndrimi Mendor

Ankthi është gjithmonë në sfond për shkak të kontaktit të përditshëm me sëmundjen dhe rrezikut të vdekjes. Pra ankthi çon në shqetësime, somatizim, qëndrime obsesive, depresion, agresion, etj.<sup>42,43</sup>

Sot, për shkak të përparimeve shkencore dhe mjekësore, pacientët mbijetojnë me probleme që në atë kohë ishin vdekjeprurëse, por kjo mbijetesë shpesh shoqërohet me shkallë të ndryshme të aftësisë së kufizuar, duke shkaktuar varësi dhe një nevojë më të madhe si për kujdesin mjekësor, ashtu edhe atë shoqëror. Plakja progresive e popullsisë së dializës dhe komorbiditeti më i madh është një fakt, dhe marrëdhënia e ngushtë midis cilësisë së jetës dhe rezultatit të vdekshmërisë konfirmon rëndësinë e përfshirjes së shënuesve të cilësisë së jetës në menaxhimin klinik të pacientëve. Për më tepër, tani pacientët jo vetëm që kanë një pritje për të mbijetuar, por gjithashtu presin të arrijnë një nivel të caktuar të mirëqënies.<sup>44,45</sup>

Sëmundja ndikon në gjëndjen fizike dhe sociale të pacientit. Një ndër shënjat psikosociale më të hasura të pacientit është depresioni dhe mungesa e shoqërizimit.

### **6.5.2. ROLI I INFERMIEREVE NE PERMIRESIMI E SHENDETIT TE PACIENTVE ME CKD**

Në Shqipëri, kujdesi infermieror i ofruar pacientëve ESRD ka një rëndësi të veçantë për shkak të pjesës së madhe të pacientëve që vuajnë nga insuficienca renale kronike dhe numri i madh i atyre që janë në hemodializë. Për më tepër, cilësia e kujdesit të ofruar shoqërohet me rolin e infermiereve nga nefrologjia, me ekspertizë të specializuar dhe ndërveprim pacient-infermier janë parashikues të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e kujdesit të ofruar. Kjo është arsyeja pse përvojat e pacientëve mund të ofrojnë reagime të vlefshme për infermierët në mënyrë që të rivlerësojnë, të vendosin qëllime dhe të përmirësojnë cilësinë dhe sigurinë e kujdesit të ofruar. Në këtë kontekst, studimi aktual ka për qëllim të eksplorojë përvojat e pacientëve me hemodializë në lidhje me kujdesin infermieror të siguruar, duke përdorur një metodë cilësore metodologjike, bazuar në epistemologjinë fenomenologjike. Infermierët janë kujdestarë për pacientët dhe ndihmojnë në menaxhimin e nevojave fizike, parandalimin e sëmundjes dhe trajtimin e kushteve shëndetësore. Për ta bërë këtë, ata duhet të vëzhgojnë dhe monitorojnë pacientin, duke regjistruar çdo informacion të rëndësishëm për të ndihmuar në marrjen e vendimeve për trajtimin.

Gjatë gjithë procesit të trajtimit, infermierët ndjekin përparimin e pacientit dhe veprojnë në përputhje me rrethanat me interesat më të mira të pacientit. Ata janë përgjegjës për kujdesin holistik të pacientëve, i cili përfshin nevojat psikosociale, zhvillimore, dhe shpirtërore të individit.

Roli i infermierit është të ruajë dinjitetin e pacientit gjatë gjithë trajtimit dhe kujdesit. Kjo mund të përfshijë bërjen e sugjerimeve në planin e trajtimit të pacientëve, në bashkëpunim me profesionistë të tjerë të shëndetit.

Infermierët luajnë një rol kryesor në menaxhimin e pacientëve me CKD. Ndhimojne dhe aftësojne pacientet që të jenë të vetëdijshëm për gjendjen e tyre, dhe edukojne ata për të marrë vendime të informuara në lidhje me trajtimin afatgjatë, që mendohet se është i dobishëm. Ata duhet të mbrojnë dhe të kujdesen për pacientët me të gjitha origjinat etnike dhe prejardhje fetare dhe t'i mbështesë ata përmes shëndetit dhe sëmundjes. Pacienti është përparësia e parë e infermierit.<sup>147</sup>

Bazuar ne konsideratat etike, ne informuam pjesemarresit per qellimin e studimit, privatesine dhe konfidencialitetin duke i siguruar qe pyetesori ishte anonim dhe te dhenat nuk do te jene te identifikueshme. Nje konsent (pelqim) i informuar oral (me goje) u sigurua prej te gjithe pjesemarresve.

Studimi u aprovua nga bordi i etikes se Fakultetit te Shendetit ne Universitetin e Vlores "Ismail Qemali", Nr 102/2 prot. date 09.06.2020 dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal te Gjirokastrës, Nr 457 prot. date 22.06.2020 perpara fillimit te studimit.

## 8. REZULTATET

---

### 8.1. PARAQITJA DESKRIPTIVE E VARIABLAVE

Ne kete seksion do te pershkruajme paraqitjen deskriptive te variablave ne lidhje me: karakteristikat socio-demografike dhe komorbiditetin e pjesemarresve; treguesit e cilesise se jetes te grupuar ne 3 kategori si komponenti fizik, mendor dhe i semundjes se veshkave; rezultatet e cilesise se kujdesit vaskular.

**Tabela 1: Te dhenat socio-demografike te pacienteve.**


Mosha (vjec)	Numri	%
deri 30 vjec	1	2.0%
31-40 vjec	5	10.0%
41-50 vjec	9	18.0%
51-60 vjec	20	40.0%
61-70 vjec	10	20.0%
mbi 70 vjec	5	10.0%
<b>Gjinia</b>		
Mashkull	32	64.0%)
Femer	18	36.0%
<b>Statusi civil</b>		
Beqar	10	20.0%
I/e Martuar	40	80.0%
<b>Arsimimi</b>		
9 vjecar	14	28.0%
I mesem	20	40.0%
Profesional	9	18.0%
Universitar	7	14.0%
<b>Niveli ekonomik</b>		
I ulet	13	26.0%
Mesatar	36	72.0%
I larte	1	2.0%



<b>Vendbanimi</b>		
Fshat	18	36.0%
Qytet	32	64.0%
<b>Punesimi</b>		
I papune	18	36.0%
I paafte	3	6.0%
Student	1	2.0%
Shtepiake	5	10.0%
Me kohe te plote	6	12.0%
Me kohe te pjeseshme	10	20.0%
Pensionist	7	14.0%

### Mosha


Nga tabela shihet se mosha mesatare e pacienteve eshte Mes = 55.54 vjec me devijim standart DS=12.27 vjet, mosha minimale Min = 27 vjec dhe mosha maksimale Max=81 vjec. Grafiku i meposhtem paraqet te dhenat mbi shperndarjen e pacienteve sipas moshes.



**Grafiku 1/1**

## Gjinia


Sipas gjinise nga analiza kemi se nga 50 paciente, 32 (64 %) jane meshkuj dhe 18 (36 %) femra. Grafiku i meposhtem paraqet te dhenat mbi shperndarjen e pacienteve sipas gjinise



**Grafiku 1/2**

## Statusi Civil.


Sipas statusit civil nga analiza kemi se nga 50 paciente, 10 paciente ose 20 % , nuk jane te martuar dhe 40 paciente ose 80 % jane te martuar. Grafiku i meposhtem paraqet te dhenat mbi shperndarjen e pacienteve sipas statusit civil.



**Grafiku 1/3**

## Arsimimi


Sipas arsimimit kemi se nga 50 paciente, 14 paciente ose 28 % e tyre jane me arsim 9 vjecar, 20 paciente ose 40% me arsim te mesem, 9 paciente ose 18% e tyre me arsim profesional dhe 7 paciente ose 14% me arsim universitar. Pjesa me e madhe jane me arsim te mesem. Grafiku i meposhtem paraqet te dhenat mbi shperndarjen e pacienteve sipas arsimimit te tyre.



**Grafiku 1/4**

## Niveli ekonomik.


Sipas nivelit ekonomik nga analiza kemi se nga 50 paciente, 13 paciente ose 26 % jane me nivel ekonomik te ulet, 36 paciente ose 72% e tyre me nivel mesatar dhe 1 pacient ose 2 % me nivel ekonomik te larte. Grafiku i meposhtem paraqet te dhenat mbi shperndarjen e pacienteve sipas nivelit ekonomik.



**Grafiku 1/5**

## Vendbanimi


Sipas vendbanimit rreth 18 paciente ose 36 % e pacienteve jane me banim ne fshat dhe 32 paciente ose 64 % e tyre me banim ne qytet. Grafiku i meposhtem paraqet te dhenat mbi shperndarjen e pacienteve sipas vendbanimit.



**Grafiku 1/6**

## Punesimi.

Nga analiza e punesimit te pacienteve shihet se vetem 6 % jane ne pune me kohe te plote dhe afro 10 % ne pune me kohe te pjeseshme. Rreth 36% jane papune ose shtepiake, 6% jane te paafte (invalide), 14% jane pensioniste dhe 2% e pacienteve jane studente. Grafiku i meposhtem paraqet te dhenat mbi shperndarjen e pacienteve sipas punesimit.



**Grafiku 1/7**

**Semundjet qe mendohet se shkaktojne insuficiencen renale te pacienteve qe i nenshtrohen hemodializes, pjesemarres ne studim.**

Pacientet jane pyetur edhe ne lidhje me ate se cfare mendojne ata se e shkakton insuficiencen e tyre renale dhe pergjigjet jepen ne **Tabelen 1.1**. Pjesa me e madhe e pacienteve (64%) mendojne se insuficienca e veshkave te tyre shkaktohet nga hipertensioni, 50% nga diabeti, 54% nga semundja policistike e veshkes, 12% nga glomerulonephriti kronik dhe 8% nga Pylonephriti.

**Tabela 1.1**


<b>Cfare e shkakton semundjen tuaj?</b>	<b>HTA</b>	<b>Diabeti</b>	<b>Semundja policistike e veshkes</b>	<b>Glomerulo-nephriti kronik</b>	<b>Pyelonephriti</b>
Numri i pacienteve	32	25	27	6	4
%	64%	50%	54%	12%	8%

Gjithashtu nga **Tabela 1.2** mund te shihet shperndarja e numrit te semundjeve shkaktare sipas pacienteve. Te gjithe pacientet kane semundje shoqeruese qe mendojne se shkaktojne semundjen e tyre te veshkave. Keshtu, 42% kane 1 semundje shoqeruese, 22% kane 2 semundje dhe 36% kane 3 semundje shoqeruese.

**Tabela 1.2**

<b>Numri i semundjeve shkaktare sipas pacientit</b>	<b>Numri i pacienteve</b>	<b>%</b>
1	21	42%
2	11	22%
3	18	36%

Grafiku i meposhtem paraqet te dhenat mbi shperndarjen e pacienteve sipas numrit te semundjeve qe mendojne se kane shkaktuar insuficiencen renale kronike.



**Grafiku 1/8**

Bazuar ne **te dhenat e karteles** per secilin pacient, po paraqesim informacionin klinik rreth semundjeve bashkeshoqeruese te diagnostikuara ose komorbiditeti

**Tabela 1.3**

<b>Semundje bashkeshoqeruese sipas vleresimit klinik</b>	<b>HTA sekondare</b>	<b>Diabet mellitus</b>	<b>Anemi Sekondare</b>	<b>Hepatit B/C</b>
Numri i pacienteve	32	25	24	10
%	64%	50%	48%	20%
<b>Nr. i komorbiditetit</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4<math>\geq</math></b>
Numri i pacienteve	7	22	21	0
%	14%	44%	42%	0%


Nga te dhenat klinike te paraqitura ne tabelen 1.3 shohim se shumica e pacienteve 64% kane HTA sekondare dhe 44 % e tyre kane 2 semundje bashkeshoqeruese e ndjekur nga 42% e tyre me 3 semundje bashkeshoqeruese qe tregon nje nivel te larte problemesh shtese te shendetit.

## TREGUESIT E CILESISE SE JETES.

*Piket me te uleta tregojne cilesi me te keqe te jetes sipas kategorive te klasifikimit.*

**Tabela 2: Kategorite e Cilesise se jetes se pacientit dhe piket e vleresimit**

Kategorite	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Piket mesatare te KDCS	50	37.83	86.07	56.3941	11.05962
Piket mesatare te PCS	50	6.25	88.75	41.8750	17.60175
Piket mesatare te MCS	50	30.50	85.63	50.3433	10.37532
Mesatarja e pergjithshme	50	30.67	86.82	49.5375	10.72791



**Grafiku 9**

**Grafiku 2**

Rezultati total i i SF-36 me dy komponentet e saj plus KDCS eshte **49.53±10.72**, i paraqitur ne **tabelen 2**. Nga analiza e pikeve te arritura ne cdo kategori pyetjesh verehet se :


1- Ne kategorine e pare "**Komponenti i semundjes se veshkave**" kemi 43 pyetje te grumbulluara ne 11 fusha te paraqitura ne Tabelen 2.1 dhe Grafikon 2.1.

**Tabela 2.1**

Mesataret e pikeve te KDCS	Nr. i pyetjeve	N	Min	Max	Mesatarja	Std. Devijim
Simptomat/problemet	12	50	2.55	100	56.55	24.00
Efektet e semundjes	8	50	2.13	93.75	38.48	25.65
Ngarkesa e semundjes	4	50	0	100	17.87	19.06
Punesimi	2	50	0	100	20	28.57
Funksionet Njohese	3	50	20	100	67.46	22.52
Bashkeveprimi social	3	50	20	100	69.62	20.08
Aktiviteti seksual	2	50	0	100	64.86	27.86
Cilesia e gjumit	4	50	30	90	60.7	13.00
Mbeshtetja sociale	2	50	0	100	81.66	28.42
Mbeshtetja e stafit te dializes	2	50	25	100	83.75	20.24
Kenaqesia e pacientit	1	50	0	100	61.82	19.17
<b>Mesatarja e KDCS</b>	43	50	37.83	86.07	56.39	11.05

Nga tabela vërejmë se mesatarja e pikeve të KDCS = 56.39 pike, Min = 37.83, Max = 86.07 pike dhe Dev. Standart = 11.06 pike.

**Grafiku 10**



Nga **tabela 2.1** shihet se piket më të ulëta të perkasin vleresimit të “Ngarkesës së sëmundjes” të pacientëve. Mesatarja e pikeve = 17.87 pike, Min=0 pike, Max=100 pike dhe Dev. Standart=19.06 pike. Gjithashtu vërejmë se pike të ulëta të perkasin edhe vleresimit të “Punësimit” të pacientëve. Mesatarja e pikeve = 20 pike, Min=0 pike, Max=100 pike dhe Dev. Standart=28.57 pike.



**Tabela 2.2**

<b>Ngarkesa e semundjes</b>	<b>Piket mesatare</b>
Semundja ime e veshkave ndikon shume ne jeten time	20.5
Shume nga koha ime eshte shpenzuar per semundjen time te veshkave	10
Ndihem i merzitur ne lidhje me semundjen time te veshkave	13.5
Ndihem si nje barre per familjen time	27.5

Nga **tabela 2.2** shihet se piket me te uleta i perkasin vleresimit te sasise se kohes qe harxhohet per semundjen e veshkave,  $Mes=10$  pike dhe merzitjes per shkak te semundjes se veshkave,  $Mes=13.5$  gje qe tregojne per cilesi te keqe te jetes se tyre.

**Tabela 2.3**

<b>Punesimi</b>	<b>Piket mesatare</b>
Gjate 4 javeve te fundit keni punuar ne nje pune me pagese?	14
Shendeti juaj ju pengon te punoni ne nje pune me pagese?	26

Vetem 7 paciente kane punuar gjate 4 javeve te fundit ne nje pune me pagese, ndersa 37 paciente shprehen se shendeti i pengon te punojne ne nje pune me pagese me mesatare pikesh 26 (Tabela 2.3).

**Tabela 2.4**

<b>Efektet e semundjes</b>	<b>Piket mesatare</b>
Kufizim i lengjeve?	22.52
Kufizim i dietes?	26.52
Aftesia juaj per pune rreth shtepise?	32.54
Aftesia juaj per te udhetuar?	37.52
Duke qene i varur nga mjeket dhe personeli tjetër mjeksor?	48.6
Stres ose shqetesime te shkaktuara nga semundja e veshkave?	34.56
Jeta juaj seksuale?	47.56
Aparenca juaj personale?	58.02

Nga **tabela 2.4** shohim se vleresimi i “ Efektet e semundjes ” ka mesatare pikesh te uleta. Mesatarja e pikeve = 38.48 pike, Min=2.13 pike, Max=93.75 pike dhe Dev.Standart = 25.65 pike. Piket me te uleta, qe flasin edhe per cilesi me te keqe te jetes se pacienteve, i perkasin ”Kufizimit te lengjeve” Mes = 22.52 pike,”Kufizim i dietes” Mes = 26.52 pike, ”Aftesise per pune rreth shtepise: Mes = 32,54 pike etj. Edhe drejtimet e tjera kane pike me te uleta se 50 pike, pervec “Aparences personale” qe ka Mes = 58 pike.


2- Ne kategorine e dyte ”**Komponenti Fizik i Semundjes** ” kemi 21 pyetje te grumbulluara ne 4 fusha te paraqitura ne Tabelen 3.1 dhe Grafikon 3.1.

**Tabela 3.1**

Mesataret e pikeve te PCS sipas klasifikimeve	Numri i pyetjeve	N	Min	Max	Mesatarja	Std. Dev
Funksionet fizike	10	50	.0	95	51.10	25.19
Aktiviteti fizik	4	50	.0	100	33.50	28.39
Dhimbja	2	50	.0	100	40.30	27.49
Gjendja e pergjithshme	5	50	10.0	75	42.60	15.75
<b>Mesatarja e PCS</b>	21	50	6.25	88.75	41.87	17.60

Mesatarja e pikeve te PCS eshte Mes = 41.87 pike. Min=6.25 pike dhe Max=88.75 pike dhe Dev.Standart=17.60 pike.

**Grafiku 11**



Nga **tabela 3.1** shihet se piket me te uleta (Cilesi me e keqe e jetes) paraqiten te treguesi i vleresimit te aktivitetit fizik te pacientit. Mes=33.5 pike si edhe “Dhimbjes” me Mes=40.3 pike

**Tabela 3.2**

<b>Aktiviteti fizik</b>	<b>Piket mesatare</b>
Gjate 4 javeve te shkuara keni patur reduktim te kohes qe kaloni per pune ose aktivite te tjera si rezultat i shendetit fizik?	22
Gjate 4 javeve te shkuara keni realizuar me pak se sa ju do t'u pelqente si rezultat i shendetit fizik?	34
Gjate 4 javeve te shkuara keni qene i kufizuar ne llojin e punes ose aktivite te tjera si rezultat i shendetit fizik?	40
Gjate 4 javeve te shkuara keni patur veshtiresi ne kryerjen e punes ose aktiviteve te tjera si rezultat i shendetit fizik?	38

Ne **tabelen 3.2** verehet se piket me te uleta i perkasin vleresimit te reduktimit te kohes qe kalohet per pune dhe aktivite te tjera per arsye te semundjes se veshkave, Mes=22 pike. Gjithashtu, edhe per vleresimin e faktit qe pacienti gjate 4 javeve te fundit ka realizuar me pak aktivite sa do te donte te bente, Mes=34 pike, etj.

**Tabela 2**

<b>Dhimbja</b>	<b>Piket mesatare</b>
Sa shume dhimbje trupore keni patur gjate 4 javeve te kaluara?	44.1
Sa shume dhimbja ka ndikuar ne punen tuaj normale (shtepi ose jashte saj) gjate 4 javeve te shkuara?	36.5

Gjithashtu, edhe lidhur me “Dhimbjen” jane arritur piket me te uleta, qe flasin per cilesi te keqe te jetes se pacienteve. Keshtu, nga **tabela 3.3** verehet se piket me te uleta paraqiten ne Ndikimin e dhimbjes ne punen normale rreth shtepise, Mes=36.5 pike si edhe ne vleresimin e dhimbjeve trupore, Mes=44.1 pike.

3- Ne kategorine e trete” ***Komponenti Mendor i Semundjes***” kemi 11 pyetje te grumbulluara ne 4 fusha (Tabela 4.1) te paraqitura ne Tabelen 4.1 dhe Grafikun 4.1.

**Tabela 4.1**

Mesataret e pikeve te MCS	Nr. i pyetjeve	N	Min	Max	Mesatarja	Std. Deviation
Mireqenie emocionale	5	50	20	88	53.04	18.12
Funksionet emocionale	3	50	0	100	41.33	28.22
Aktiviteti social	2	50	0	87.5	49.50	21.12
Energjia/Lodhja	4	50	30	75	57.50	12.74
Mesatarja e MCS	16	50	30.5	85.63	50.34	10.37

Mesatarja e pikeve te KDCS=50.34 pike. Min=30.5 pike dhe Max=85.63 pike dhe Dev.Standart=10.37 pike. Nga **tabela 4.1** shihet se piket me te uleta i perkasin vleresimit te “Funksioneve emocionale” te pacienteve. Mes=41.33 pike. Min=0 pike dhe Max=100 pike dhe Dev.Standart=28.22 pike. Gjithashtu, edhe vleresimi i aktivitetit fizik ka marre pike te uleta, Mes=49.5 pike, Min=0 pike dhe Max=87.5 pike dhe Dev.Standart =21.12 pike.

**Tabela 4.2**

Funksionet emocionale	Piket mesatare
Gjate 4 javeve te shkuara keni patur reduktim te kohes qe kaloni per pune ose aktivitete te tjera si rezultat i problemeve emocionale?	52
Gjate 4 javeve te shkuara keni realizuar me pak aktivitete se sa ju do t'u pelqente si rezultat i problemeve emocionale?	30
Gjate 4 javeve te shkuara nuk keni bere pune ose aktivitete me kujdesin e zakonshem si rezultat i problemeve emocionale?	42

Nga analiza e metejshme e funksioneve emocionale, verehet se piket me te uleta jane ne vleresimin e faktit qe pacientet kane realizuar me pak aktrivitete nga sa do te donin per shkak te problemeve emocionale, Mes=30 pike dhe me pas vjen vleresimi i faktit qe ata nuk kane arritur te kryejne punet me kujdesin e zakonshem per arsye te problemeve emocionale qe lidhen me semundjen, Mes=42 pike (**Tabela 4.2**).

## 8.2. PARAQITJA ANALITIKE E VARIABLAVE

### 8.2.1. ANALIZA E LIDHJES MIDIS KDCS DHE FAKTOREVE SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE KOMORBIDITETIT.

Nga analiza e lidhjes se KDCS me faktoret socio-demografike dhe komorbiditetin kemi rezultatet e meposhtme.

**Tabela 3 Lidhja midis Mesatareve te KDCS dhe treguesve socio-demografike & komorbiditeti**

Treguesi socio-demografik	F (ANOVA)	P (ANOVA)
Mosha	F= 0.338	p=0.887
Niveli arsimor	F= 1.533	p=0.019
Statusi civil	F = 0.056	p=0.814
Niveli ekonomik	F = 0.663	p=0.020
Gjinia	T = -0.675	p=0.504
Punesimi	T = 0.665	p=0.512
Vendbanimi	T = 0.420	p=0.676
Komorbiditeti	F = 5.123	p=0.010

Nga analiza e ndryshimit te mesatareve midis kategorive te ndryshme te pacienteve sipas treguesve socio-demografike jane verejtur ndryshime te rendesishme statistikore aty ku vlera e  $p \leq 0.05$ . Rezultatet tregojne se jane verejtur ndryshime te rendesishme statistikore ne mesataren e pikeve per vleresimin e KDCS te pacientet me nivel te ndryshem arsimor (0.019) dhe ekonomik (p=0.020). Per te analizuar me tej kete lidhje kemi ndertuar regresionin linear te thjeshte midis pikeve te KDCS dhe nivelit arsimor. Pasi kemi bere kodimin e te dhenave (1=arsim i larte, 0=tjeter) kemi ekuacionin  $Y$  (Mes KDCS)=  $55.187+8.622 X$ .

Keshtu, pacientet me nivel arsimor te larte (X=1) kane mesatare pikesh me te larte, 8.6 pike me shume se ata me nivele me te uleta arsimimi (X=0). Tabela e meposhtme paraqet te dhenat e treguesve te regresionit:

**Tabela 5.4: Analize e regresionit**

Model	Koeficient i pastandartizuar		Koeficient i standartizuar	t	Sig.	
	B	Std. Error	Beta			
1	(Constant)	55.187	1.639		33.667	.000
	Arsimi i larte	8.622	4.381	.273	1.968	.050

Nga ndertimi i regresionit linear te thjeshte midis pikeve te KDCS dhe nivelit ekonomik pasi kemi bere kodimin e te dhenave (1=tjeter, 0=nivel i ulet ) kemi ekuacionin  $Y$  (Mes KDCS) =  $50.816+5.484 X$

Keshtu, pacientet me nivel me te larte ekonomik (X=1) kane mesatare pikesh me te larte se ata me nivel te ulet ekonomik (X=0) me 5.5 pike. Tabela e meposhtme paraqet te dhenat e treguesve te regresionit:

**Tabela 5.2: Analize e regresionit**

Model	Koeficient i pastandartizuar		Koeficient i standartizuar	t	Sig.	
	B	Std. Error	Beta			
1	(Constant)	50.816	3.069		17.536	.000
	Niveli ekonomik	5.484	3.567	.140	.977	.034

Jane verejtur ndryshime te rendesishme statistikore ne mesataren e pikeve per vleresimin e KDCS te pacientet me numer te ndryshem semundjesh shoqeruese. Kete ndryshim e tregon vlera e probabilitetit **p=0.010, pra p<0.05.**

Per te pare se si eshte ky ndryshim pikesh ndertojme Regresionin linear midis mesatareve te KDCS dhe numrit te semundjeve shoqeruese te pacienteve.

Nga te dhenat e programit shohim se Sig.=p=0.011, pra p<0.05 dhe ekuacioni i regresionit eshte :  $Y = 64.96 - 4.414X$  qe tregon se me rritjen me 1 njesi te komorbiditetit mesatarja e pikeve KDCS ulet me 4.4 pike, pra edhe cilesia e jetes perkeqesohet.

**Tabela 5.3: Analize e regresionit**

Model	Koeficient i pastandardizuar		Koeficient i standartizuar	t	Sig.	
	B	Std. Error	Beta			
1	(Constant)	64.957	3.572		18.184	.000
	Komorbiditet	-4.414	1.676		-2.633	.011

Nese analizohet lidhja e semundjeve bashkeshoqeruese (Hipertension, diabeti, anemia dhe hepatiti) me komponentin KDCS, verhet:

**Tabela 5.4: Vleresimi i lidhjes midis KDCS dhe komorbiditetit**

Lloji i semundjes	Mesatarja e pikeve te KMCS
Hipertension	55.17
Diabet	52.57
Hepatit B ose C	54.71
Anemi	58.50

Tabela e mesiperme tregon se piket me te uleta jane verejtur te pacientet qe kane semundje shoqeruese *diabetin*.

## **8.2.2. ANALIZA E LIDHJES MIDIS PCS DHE FAKTOREVE SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE KOMORBIDITETIT**

Nga analiza e lidhjes se PCS me faktoret socio-demografike dhe komorbiditetin kemi rezultatet e meposhtme.

**Tabela 6: Lidhja midis Mesatareve te PCS dhe treguesve socio-demografike & komorbiditeti.**

Treguesi socio-demografik	F (ANOVA)	p (ANOVA)
Mosha	F = 0.649	p=0.044
Niveli arsimor	F = 0.636	p=0.596
Statusi civil	T = 1.450	p=0.159
Niveli ekonomik	F = 0.331	p=0.720
Gjinia	t= 1.054	p=0.301
Punesimi	F= 0.338	p=0.047
Vendbanimi	t=0.559	p=0.579
Komorbiditeti	F= 4.051	p=0.024

Nga analiza e ndryshimit te mesatareve midis kategorive te ndryshme te pacienteve sipas treguesve socio-demografike jane verejtur ndryshime te rendesishme statistikore me variablat **mosha** ( $p=0.044<0.05$ ) dhe **punesimi** ( $p=0.047<0.05$ ).

Nga ndertimi i regresionit linear te thjeshte midis *pikëve te PCS dhe punesimit* te pacientit, pasi kemi bere kodimin e te dhenave (0=papune/invalid, pension, shtepiake, 1=i punesuar/me kohe te plote ose te pjeseshme) kemi ekuacionin:  $Y(\text{Mes PCS})= 42.857-3.274X$ . Tabela e meposhtme paraqet te dhenat e treguesve te regresionit:

**Tabela 5: Analize e regresionit per lidhjen PCS me Punesimin**

Model	Koeficient i pastandartizuar		Koeficient i standartizuar	t	Sig.	
	B	Std. Error	Beta			
1	(Constant)	42.857	2.995		14.310	.000
	Punesimi	-3.274	5.468	-.086	-.599	.552

Keshtu, pacientet e punesuar ( $X=1$ ) kane mesatare pikesh me te ulet te PSC se ata papune me 3.3 pike, per pasoje edhe cilesi me te ulet jete persa i perket komponentit fizik. Pra, angazhimi ne pune ndikon negativisht ne mireqenien fizike te pacientit.

Nga ndertimi i regresionit linear te thjeshte midis pikeve te *PCS dhe moshes* se pacientit, pasi kemi bere kodimin e te dhenave (0=moshat deri 50 vjec,1=moshat mbi 50 vjec) kemi ekuacionin:  $Y(\text{Mes PCS})= 44.420-3.534 X$ . Keshtu, nga ekuacioni kuptojme se pacientet mbi 50 vjec ( $X=1$ ) kane mesatare pikesh me te ulet se ata nen 50 vjec me 3.5 pike, per pasoje edhe cilesi me te ulet jete persa i perket komponentit fizik. Pra me rritjen e moshes, cilesia e jetes lidhur me PCS perkeqesohet.

Tabela e meposhtme paraqet te dhenat e treguesve te regresionit:

#### Analize e regresionit

Model	Koeficient i pastandartizuar		Koeficient i standartizuar	t	Sig.
	B	Std. Error	Beta		

1	(Constant)	44.420	4.733		9.385	.000
	Mosha	-3.534	5.578	-.091	-.634	.044

Jane verejtur ndryshime te rendesishme statistikore ne mesataren e pikeve per vleresimin e *PCS te pacientet me numer te ndryshem semundjesh shoqeruese*. Kete ndryshim e tregon vlera e probabilitetit  $p=0.024$ , pra  $p<0.05$ . Per te pare se si eshte ky ndryshim pikesh ndertojme Regresionin linear midis mesatareve te PCS dhe numrit te semundjeve shoqeruese te pacienteve.

**Tabela 6: Analize e regresionit per lidhjen PCS me Moshen**

Model	Koeficient i pastandartizuar		Koeficient i standartizuar	T	Sig.	95.0% Interval i Besimit per B		
	B	Std. Error	Beta			Kufi i poshtem	Kufi i siperm	
	1	(Konstant)	56.813			5.690	9.985	.000
	Komorbidityt	-7.469	2.597	-.383	-2.876	.006	-12.691	-2.247

Nga te dhenat e programit shohim se  $Sig.=p=0.006$ , pra  $p<0.05$  dhe ekuacioni i regresionit eshte:  $Y= 56.81-7.469 X$ . Ekuacioni tregon se me rritjen me 1 njesi te komorbidityt mesatarja e pikeve PCS ulet me 7.5 pike, pra edhe cilesia e jetes perqesohet.

Nese analizohet lidhja e semundjeve bashkeshoqeruese (Hipertension, diabeti, anemia dhe hepatiti) me komponentin PCS, verehet:

**Tabela 7: Vleresimi i lidhjes midis PCS dhe komorbidityt**

Lloji i semundjes	Mesatarja e pikeve te PCS
Hipertension	37.59
Diabet	35.25
Anemi	41.47
Hepatit	41.45

Tabela e mesiperme tregon se piket me te uleta jane verejtur te pacientet qe kane semundje shoqeruese diabetin dhe hipertensionin.

### 8.2.3. ANALIZA E LIDHJES MIDIS MCS DHE FAKTOREVE SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE KOMORBIDITETIT

Nga analiza e lidhjes se MCS me faktoret socio-demografike dhe komorbidityt kemi rezultatet e meposthme.



**Tabela 7: Lidhja midis mesatareve te MCS dhe treguesve socio-demografike dhe komorbiditetit.**

Treguesit socio-demografike	F (ANOVA)	p (ANOVA)
Mosha	F=1.402	p=0.242
Niveli arsimor	F=0.948	p=0.026
Statusi civil	T = 1.333	p=0.196
Niveli ekonomik	F = 0.038	p=0.963
Gjinia	T = -0.319	p=0.752
Punesimi	F = 2.349	p=0.048
Vendbanimi	T = -0.414	p=0.681
Komorbiditeti	F = 0.081	p=0.923

Nga analiza e ndryshimit te mesatareve te MCS midis kategorive te ndryshme te pacienteve sipas treguesve socio-demografike eshte verejtur ndryshim i rendesishem statistikor lidhur me **punesimin** , **p=0.048** dhe **niveli arsimor (p=0.026)**. *Nuk eshte verejtur ndryshim i rendesishme statistikor ne mesataren e pikeve per vleresimin e MCS te pacientet me numer te ndryshem semundjesh shoqeruese.* Kete ndryshim e tregon vlera e probabilitetit  $p > 0.05$ .

Per te analizuar me mire lidhjen midis pikeve MCS dhe faktoreve punesim dhe nivel arsimor ndertojme Regresionin linear midis mesatareve te **MCS dhe punesimit te pacienteve**.

**Tabela 7.1: Analize e regresionit per lidhjen e MCS dhe Punesimi**

Model	Koeficient i pastandartizuar		Koeficient i standartizuar	t	Sig.	
	B	Std. Error	Beta			
1	(Constant)	52.451	1.683		31.173	.027
	Punesimi	3.026	1.072	-.313	-2.287	.027

Nga te dhenat e analizes shohim se  $\text{Sig.} = p = 0.027$ , pra  $p < 0.05$  dhe ekuacioni i regresionit eshte :  $Y = 52.45 + 3.026 X$ , qe tregon se me kalimin nga papune ne te punesuar te pacientit mesatarja e pikeve MCS rritet me 3 pike, pra edhe cilesia e jetes permiresohet kur personi punon.

Ne lidhje me **faktorin niveli arsimor** kemi ndertuar regresionin e thjeshte linear qe na jep ekuacionin linear:  $Y(\text{Mesatarja MCS}) = 40.887 - 7.060X$

Ekuacioni tregon se tek pacientet me arsim te larte mesatarja e pikeve MCS ulet me 7.1 pike, pra edhe cilesia e jetes perkeqesohet persa i perket MCS.

Tabela e meposhtme paraqet te dhenat e treguesve te regresionit:

**Tabela 7.8: Analize e regresionit per lidhjen MCS dhe Niveli arsimor**

Model	Koeficient i pastandardizuar		Koeficient i standartizuar	t	Sig.	
	B	Std. Error	Beta			
1	(Constant)	40.887	2.685		15.227	.000
	Arsimi i Larte	7.060	7.176	.141	.984	.330

#### 8.2.4. ANALIZA E LIDHJES MIDIS TREGUESVE TE KDCS ME PCS DHE MCS.

Nga analiza e *lidhjes midis KDCS dhe PCS* kemi verejtur se ka ndryshime te rendesishme statistikore midis treguesit te KDCS ne paciente me tregues PCS te ndryshme.

Vlera e  $p=0.000$  e llogaritur ne procedure ANOVA , ne kete rast e konfirmon kete.

Duke ndertuar regresionin linear ne kete rast kemi ekuacionin:

$$Y=40.447 + 0.381X$$

$$Y=KDCS$$

$$X=PCS$$

Nga ekuacioni shihet se me rritjen me 1 pike te mesatares se komponentit fizik (PCS) te pacientit, mesatarja e komponentit te semundjes se veshkave (KDCS) rritet me 0.381pike.

**Tabela 9: Analize e regresionit per lidhjen KDCS me komponentin fizik PCS**

Model	Koeficient i Pastandardizuar		Koeficient i Standartizuar	t	Sig.	
	B	Std. Error	Beta			
1	(Constant)	40.447	3.272		12.363	.000
	PCS	.381	.072	.606	5.280	.000

Nga analiza e *lidhjes midis KDCS dhe MCS* kemi verejtur se ka ndryshime te rendesishme statistikore midis treguesit te KDCS ne paciente me tregues MCS te ndryshme. Vlera e  $p=0.016$  e llogaritur ne procedure ANOVA, ne kete rast e konfirmon kete. Duke ndertuar regresionin linear ne kete rast kemi ekuacionin:

$$Y=38.272 + 0.360X$$

$$Y=KDCS$$

$$X=MCS$$

Nga ekuacioni shihet se me rritjen me 1 pike te mesatares se komponentit mendor (MCS) te pacientit, mesatarja e komponentit te semundjes se veshkave (KDCS) rritet me 0.360 pike.

**Tabela 8.1: Analize e regresionit per lidhjen KDCS me komponentin mendor MCS**

Model		Koeficient i pastandartizuar		Koeficient i standartizuar	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	38.272	7.441		5.143	.000
	MCS	.360	.145	.338	2.486	.016

### 8.3.VLERESIMI I TEKNIKES SE KUJDESIT INFERMIEROR PER AKSESIN VASKULAR.

Rezultatet e observimit te realizimit te duhur ose jo te teknikes se kujdesit per aksesin vaskular per te dy tipet jane paraqitur ne **tabelen e meposhtme 9**.

**Tabela 10**

	<b>Teknika e kujdesit infermieror per aksesin vaskular.</b>	<b>Nr.i rasteve qe eshte realizuar</b>	<b>Perqindja</b>
1	Teknika e dezinfektimit	46	92.00%
2	Veshje e dorashkave	50	100.00%
3	Veshje maske	36	72.00%
4	Injeksion heparine	38	76.00%
5	Mbushje e duhur	42	84.00%
6	Mbyllja e fundit te linjës venoze ndërsa lidhni pacientin me makinën*	44	88.00%
7	Rregullimi i dozës së saktë të heparinës bazuar në rekomandimet	50	100.00%
8	Mbyllja e njerës linje ndërsa shplahet linja tjetër*	40	80.00%
9	Mbyllja e fundit te kateterit arterial kur shkepussi pacientin nga makina*	39	78.00%
10	Garze sterile mbi vendin e kateterit*	39	78.00%
11	Inserim i sakte i ages**	48	96.00%
12	Shkalla e rrjedhjes se gjakut ne fillim te HD <150**	38	76.00%
13	Futje e ages ne aneurizem**	24	48.00%
14	Distanca e ages nga fistula**	25	50.00%

\* Per kateterin venoz qendror  
\*\*Per fistulen arterio-venoze

Nga te dhenat e procedurave te kryera per cdo pacient kemi llogaritur mesataren e procedurave te realizuara per 1 pacient. Mes=11.18, Min=9 dhe Max=14 procedura.

Nga tabela shihet se ka patur probleme me disa procedura te aksesit vascular si psh: futja e ages ne aneurizem ka ndodhur ne 48% te rasteve, respektimi i distances se ages nga fistula nuk eshte realizuar

ne 50% te rasteve. Nderkohe qe procedura te tjera si veshja e dorezave, rregullimi i dozës së heparines, teknika e desinfektimit, inserimi i sakte i ages jane realizuar ne 90-100% te rasteve.

**Tabela 11: Cilesia e kujdesit infermieror per aksesin vaskular**

Vleresimi i cilesise se infermierit	Lloji i aksesit		Total	Vlera p
	AFC	CVC		
Moderuar	10 (20%)	8 (16%)	18 (36%)	p= 0.012
Optimal	6 (12%)	26 (52%)	32 (64%)	
<b>Total</b>	16 (32%)	34 (68%)	50 (100%)	

**Tabela 9.1** tregon per 64% te pacienteve cilesia e kujdesit infermieror eshte optimal dhe 36% e moderuar. Nga analiza e lidhjes midis Cilesise se Kujdesit dhe llojit te aksesit vaskular verehen ndryshime te rendesishme statistikore midis pacienteve me CVC dhe AFC. Ne kete rast probabiliteti Hi-Katorr eshte  $0.012 < 0.05$ . Gjithashtu verehet se 70% e pacienteve me CVC kane vleresim optimal per kujdesin infermieror, kurse pacientet me AFC vetem 30%.

**Tabela 12: Vleresimi i lidhjes midis cilesise se kujdesit ndaj aksesit vaskular dhe komponentit fizik te cilesise se jetes.**

Analize e regresionit						
Model		Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	.121	1	.121	.519	.475
	Residual	10.981	47	.234		
	<b>Total</b>	11.102	48			

Nga analiza e lidhjes midis Cilesise se kujdesit infermieror dhe treguesit te PCS ndertojme regresionin logistic midis cilesise dhe mesatares se pikeve PCS. Nga te dhenat kemi  $p=0.475$  dhe  $F=0.519$ . Vlera  $p>0.05$  tregon qe nuk jane verejtur ndryshime te rendesishme statistikisht midis Cilesise se kujdesit infermieror per aksesin vascular dhe komponentit fizik te pacientit. Pra, cilesia e kujdesit gjate aksesit vaskular nuk ka ndikuar ne mireqenien fizike te pacienteve.

## 9. DISKUTIMI

---

### Vleresimi i cilesise se jetes tek pjesemarresit ne studim

ESRD është një sëmundje serioze dhe trajtimi është sfidues dhe gjatë gjithë jetës. Për më tepër, përkundër burimeve të konsiderueshme të përkushtuara për trajtimin e ESRD dhe duke marrë parasysh ndikimin e saj në rezultatin klinik dhe mbijetesën në pacientët me sëmundje kronike, ata vazhdojnë të përjetojnë një cilësi të zvogëluar të jetës. Prandaj, Cilësia e Jetes po bëhet një mjet premtues për matjen e përfitimeve dhe ngarkeses së terapisë dializare nga këndvështrimi i një pacienti, e cila përfshin mënyrën se si pacientët menaxhojnë shëndetin e tyre<sup>1,12</sup>. Qëllimi kryesor terapeutik është të përmirësojë aftësinë funksionuese të këtyre pacientëve në mënyrë që ata të mund të shijojnë jetën në masën e saj sa më të plotë të mundshme. Rezultatet e këtij studimi ilustronë se si funksionimi fizik, psikologjik, social, mjedisor dhe shëndeti i përgjithshëm janë prekur tek pacientët me ESRD.

Konkretisht studimi demonstroi se rezultatet e **komponentit fizik PCS** të vleresimit të cilesise se jetes ishin me te uleta se ato të komponentit mendor ose psikologjik, **MCS**. Gjetjet treguan një *kufizim të aktivitetit fizik* të pjesemarresve shkaktuar kryesisht nga *dhimbjet trupore* që njekohesisht kishin impakt negativ edhe në punën dhe jetën e përditshme të pacientit. Keto gjetje janë të ngjashme edhe me studime të tjera të cilat e lidhin edhe me faktore të tjera përveç dhimbjes si varësia nga mbështetja mjekësore, të paturit e një regjimi të rreptë trajtimi, çrregullime të gjumit, palëvizshmëri, varësia nga makineritë, dieta specifike dhe ndryshimet e imazhit të trupit<sup>19,20</sup>.

Persa i perket **komponentit KDCS**, rezultatet ishin me te mira krahasuar me studime të tjera, megjithatë gjetjet treguan sesi sëmundja e veshkave ndërhynte negativisht në jetën dhe punën e pacienteve të cilët e ndjenin veten si barë për familjen e tyre dhe që ata shpenzonin shumë nga koha e tyre për shkak të sëmundjes së tyre të veshkave, gjetje keto të krahasueshme me studime të tjera<sup>21,22</sup>.

Studimi zbuloi se rezultati total për të 3 komponentet e vleresimit të cilesise se jetes ishte i nivelit mesatar. Kjo gjetje është ne të njejten linjë me disa studime<sup>12,32</sup>, por *kundershton hipotezën e parë* ku parashikohej një cilësi e ulët e jetes së pacienteve pjesemarres që i nënshtrohen HD në rrethin e Gjirokastres. Megjithatë rezultati ynë tregon nevojën e implementimit të programeve edukuese për përmirësimin e cilesise se jetes dhe ndikimin e tij për një rezultat me të kenaqshëm. Një studim i realizuar nga Bakarman et al., tregoi pikërisht impaktin pozitiv që keto programe kanë në përmirësimin e cilesise se jetes së pacienteve me hemodializë<sup>38</sup>.

### Faktoret që kontribuojnë në cilësinë e jetes që lidhet me shëndetin të pjesemarresve në studim

Në këtë studim ne vleresuam ndikimin e faktoreve socio-demografike dhe klinike si sëmundjet bashkeshoqeruese dhe ngritem hipotezën se ekziston një lidhje midis këtyre variablave. Rezultatet treguan se pacientet *me nivel ekonomik dhe arsimor* me të lartë kishin një cilësi jete me të mirë lidhur me statusin e sëmundjes së veshkave, pra me **komponentin KDCS**. Kjo mund të shpjegohet me faktin se pacientet me të arsimuar janë me të informuar në lidhje me kujdesin ndaj shëndetit dhe fakti që mund të kenë një nivel me të lartë edhe socio-ekonomik i jep me tepër mundësi për të blerë trajtimin e kërkuar mbështetës dhe një ushqim më të shëndetshëm të kërkuar gjithashtu<sup>23</sup>.

*Niveli arsimor* u gjet i lidhur statistikisht edhe me *komponentin mendor MCS* te cilesise se jetes dhe interesant duket fakti se pacientet me *arsim te larte* ne studimin tone kane *pike me te uleta* te komponentit mendor. Referuar nje studimi te realizuar ne Rumani, kjo mund te vije edhe per shkak te asaj se niveli arsimor ben qe keta paciente te kuptojne me mire semundjen, prognozen, procedurat, medikamentet dhe te kerkojne me shume informacion per semundjen e tyre. Per kete arsye ngarkohen me teper nga ana mendore sesa ata me nivel me te ulet arsimor<sup>24</sup>. Por nga ana tjetere, kjo eshte ne kundërshtim me disa studime te tjera qe kane treguar se niveli i lartë i arsimimit është i njohur per rolin e tij thelbësor në rritjen e ndërjegjësisimit për sëmundjet kronike dhe në një aftësi më të mirë përballuese nga ana psikologjike, por jo vetem te ketyre semundjeve<sup>21,29</sup>.

Studimi yne zbuloi gjithashtu *lidhje te rendesishme te moshes me komponentin fizik* por jo me dy komponentet e tjere te cilesise. Studentet me moshe më të re perkatesisht me pak se 50 vjec ishin me te prirur per te patur nje shendet fizik me te mire, por kjo nuk ndikonte ne lidhje me ngarkesen e semundjes se veshkave dhe aspektit psikologjik te pjesemarresve. Studimet kane treguar se mosha ka nje influence sinjifikante per te tre komponentet vecanerisht ate fizik dhe mendor ku pacientet më te rinj ne moshe kane rezultatet më te larta te cilesise se jetes, ndersa e kunderta ndodh me rritjen e moshes gje qe mund te lidhet sipas studimeve te tjera me sindromat geriatrike si dëmtimi konjitiv, depresioni dhe imobiliteti etj. Prandaj, kujdesi për pacientët e moshuar me dializë kërkon vlerësim, menaxhim dhe funksion për të maksimizuar pavarësinë duke minimizuar barrën e sëmundjeve dhe simptomave<sup>12,13,21,24</sup>. Megjithate studime te tjera kane treguar se te rinjte ose adoleshentet me semundje renale kronike nuk mund të përballonin gjendjen e tyre psikologjike, sociale dhe mjedisore<sup>25</sup>. Sipas studimeve kjo mund te lidhet me faktin se ata mund te shqetësohen më shumë duke pasur një diagnozë të CKD e cila mund të ndikojë negativisht në aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet për rolin kryesor te kujdesit ndaj shendetit per te permiresuar cilesine e tyre te jetes<sup>2,25</sup>.

*Punesimi* eshte nje tjetere faktor qe ndikon ne cilesine e jetes se pacienteve me ESRD. Ne studimin tone ky faktor u gjet i lidhur statistikisht me komponentet MCS dhe PCS por me rezultate te kunderta. Keshtu te qenurit i punesuar u gjet se ka nje ndikim pozitiv ne aspektin psikologjik te pjesemarresve ne studim, por rezultate te uleta te cilesise ne lidhje me komponentin fizik. Kjo e fundit mund te shpjegohet ndoshta me faktin se angazhimi ne pune mund ti shkaktoje lodhje dhe sforcim fizik pacientit. Shumica e studimeve kane zbuluar se punesimi shoqerohet me nje cilesi jete me te mire ne pothuajse te gjitha aspektet e shendetit si fizik, social dhe psikologjik<sup>1,2,12</sup>. Disa prej tyre e shpjegojne kete gjetje me faktin se pacientët e punësuar mund të ushtrojne profesionin e tyre, të kenë imazh më të mirë të trupit, pamjen dhe vetëvlerësimin që përmirëson cilesine e jetes se tyre sesa të papunët dhe pensionistet<sup>1,26</sup>. Kurse disa studime te tjera e lidhin me pavarësinë financiare, qe në një farë mase, mund të ketë kontribuar në rezultatet më të larta të QOL në grupin e punësuar<sup>2</sup>. Por ka edhe studime qe surprizojne me gjetjet e tyre qe tregojne se pensionistet kane cilesi jete me te mire duke e interpretuar kete me faktin se popullata në pension po ndjehet më e sigurt në të gjitha aspektet e jetës së tyre sesa popullata e punësuar dhe e papunë<sup>12</sup>.

Persa i perket *faktoreve te tjere socio-demografike* studimi yne nuk gjeti lidhje te rendesishme statistikore gje qe tregon se keto variabla nuk ndikuan ne komponentet e cilesise se jetes qe analizuam ne kete studim. Keto rezultate jane ne kundërshtim me studime te tjera qe zbuluan se femrat, pacientet qe vijne nga zona rurale, pacientet e martuar ose te divorcuar jane më te prirur per nje cilesi më te ulet te jetes<sup>1,21,23,24,27</sup>. Arsyet kryesore per keto gjetje jane se femrat dhe personat e martuar kane më teper

detyrime dhe pergjegjesi ne familje apo pune shtepie te cilat rrisin stresin dhe cenojne cilesine e jetes<sup>1,21,24</sup>, por nga ana tjeter ne disa studime theksohet se familja eshte nje suport social dhe personat e martuar kane nje cilesi jete me te mire<sup>13,28</sup>. Duke marre parasysh vendbanimin, disa arsye lidhen me distancën që udhëtojnë nga zona e tyre e banimit në qendrat e dializave në qytet, koha / mënyra e transportit dhe nganjëherë nevoja për një shoqëruar<sup>12,27</sup>.

Semundjet bashkeshoqeruese ose ***komorbiditeti*** eshte nje faktor klinik qe duket se ka nje impakt negativ ne cilesine e jetes per pacientet qe i nenshtrohen hemodializes<sup>3,23</sup>. Studimi yne zbuloi se pacientet qe vuajne nga diabeti kane rezultate më të ulëta te komponentit PCS dhe KDCS, gje qe tregon se kjo semundje bashkeshoqeruese eshte nje faktor i rendesishem ne keqfunksionimin fizik dhe perkeqeson gjithashtu ngarkesen e semundjes se veshkave. Ne menyre te ngjashme studime te tjera kane rezultuar se pacientet jo diabetike kane nje cilesi jete më te mire se ata diabetike<sup>21</sup>. Persa i perket ***komponentit mendor MCS*** gjetjet treguan se semundjet bashkeshoqeruese ndikonin njesoj pa ndryshime te rendesishme statistikore gje qe ishte *ne kundërshtim* me studime te tjera te realizuar perkatesisht ne Turqi dhe Egjipt, te cilet zbuluan se hepatiti C dhe anemia preknin jo vetem shendetin fizik por edhe ate emocional. Kjo shpjegohej me faktin e gjendjes hypoksike qe shkakton anemia dhe natyren infektive apo edhe komplikacionet qe vijne nga hepatiti C me impakt negativ ne funksionimin jo vetem fizik por edhe performances konjitive, humorin dhe gjendjen psikologjike te pacienteve<sup>21,30</sup>. Në studimin tone, shumica e pacienteve kishin te pakten 2 ose 3 semundje bashkeshoqeruese te cilat ulnin mesataren e pikeve qe tregojne cilesi jo te mire te jetes. Analiza tregoi se me rritjen e 1 njesi te komorbiditetit, mesatarja e cilesise per komponentin PCS ulej me 7 pike kurse per komponentin KDCS ulej me 4.4 pike, qe jane pak a shume te ngjashme me studime te tjera<sup>12,20</sup>. Ndersa ne lidhje me ***shkaktaret e mundshem te ESRD*** studimi konkludoi se HTA e ndjekur nga diabeti ishin shkaktaret kryesore tek pacientet me hemodialize, i ngjashem me nje studim i kryer nga Rostami et al<sup>32</sup>. Megjithate, shumica e studimeve tregojne se diabeti mellitus eshte shkaktari i pare i ESRD<sup>31,34,35</sup>, nderkohe qe ekziston edhe nje kategori tjeter e origjines se panjohur<sup>32</sup>. Kurse ne nje studim te realizuar ne sherbimin e nefrologjise te Qendres Spitalore Universitare te Tiranës shkaktari primar i CKD ishte *pyelonefriti kronik*, gje qe ne studimin tone rezultoi në një perqindje më të ulët<sup>33</sup>. Rezultatet e mesiperme *vertetuan* hipotezen e dyte te studimit qe tregonte per lidhjen qe ekzistonte midis cilesise dhe faktoreve socio-demografike dhe klinike qe prekin ate.

